In language learning, the attention of the learners may be focused on particular segments, or on the language as a whole. In cases when we want to focus learners' attention on particular segments, then a segment may be a grammatical structure (a tense), a language function (expressing gratitude), a vocabulary area (food and drinks), or a phonological feature (stress or particular sounds).

Since communication basically means sending and receiving messages, learners should develop the four language skills, which are the core of communication. Development of *receptive skills*, that is *listening* and *reading* skills, will enable learners to receive messages and, depending on tasks they are expected to fulfil, select essential information. However, since language skills do not occur in isolation, but are normally integrated for communicative purposes, after having received a message, learners should be able to make decisions and respond appropriately. In a situation which involves language, their response is a communicative function, which is performed by one of the *productive skills* either by *speaking* or by *writing*.

The Learning – Centred Classroom

The objective of learning-centred teaching is to make teachers aware of the importance of learner autonomy in the classroom. The teacher has a role, to support and help learners. The learners learn more actively and with enjoyment. The environment requires a learning-centred approach that relies on participant's share in the learning, and responsibility for furthering the discussion. In all cases, learners need clear guidelines and preparation for effective discussion and participation.

The major aim or set of aims will relate to the development of learning skills. Such aims may include the following:

- To provide learners with efficient learning strategies;
- To assist learners identify their own preferred ways of learning;
- To develop skills to negotiate the curriculum;
- To encourage learners to adopt realistic goals and a timetable to achieve these goals;
- To develop learners' skills in self-evaluation.

The use of the mother tongue in the classroom

Contrary to the principles of the direct method and natural approach in language learning, which favour exclusive use of the target language, excluding the mother tongue completely from the classroom, most recent approaches today suggest that the use of the mother tongue at particular stages of foreign language learning may prove useful.

While there is clearly a place for the mother tongue in the classroom, teachers should make efforts to keep the use of the mother tongue to a minimum. Instead of translating words and/or asking learners to translate, they should demonstrate, act, use simple drawings and/or pictures, explain, give simple definitions. If teachers readily intervene with translation, as soon as learners are provided with an ‘equivalent’ word or expression, as soon as their curiosity is satisfied, they may lose interest in that particular item. In consequence, the English word or expression is easily forgotten and cannot be easily recalled. This method is easiest for teacher and learner, but may be the least memorable.

Vocabulary

Vocabulary teaching and learning is central to learning English. Words have a central place in culture, and learning words is seen by many as the main task in learning another language.

At level 1 learners identify key concepts using a range of vocabulary.

At level 1 the teacher’s role is to:

- set the task, give examples and encourage the learner;
- expose learners to language through songs;

At level 1 the learner’s role is to:

- identify and name the given items;
- sing along with peers and teacher

Possible activities at level 1:

- showing pictures in sequence;
- singing a song in English;

Cross curricular issues

Since English Language is not taught and learnt for its own sake but is seen as aim and vehicle, the Grade Three English Language Syllabus integrates topics that directly relate to other subjects, such as: arts, culture, geography, media literacy, civic education, and similar. All these are in the function of equipping learners with first of all the communicative competence, as well as other competences foreseen in the Level One Core Curriculum. During this grade, learners are provided with numerous chances to learn about cross-curricular issues, while simultaneously acquiring and reinforcing words, phrases and simple sentences in English language. Learners are exposed to these cross-curricular issues through songs, poems, drawing, crafts and other hands-on activities and are encouraged, where possible, to complete simple tasks through the facilitation of technology.

Assessment and evaluation guidelines

There are many reasons for assessing learners. Some of them are:

- to compare learners with each other;
- to see if learners have reached a particular standard;
- to help the learners' learning;
- to check if the teaching programme is successful.

Teaching means changing the learner. Teachers will always want to know how effective their teaching has been- that is, how much their pupils have changed.

This change can be in:

- The amount of English learners know;
- The quality of the English they use;
- Their ability to use English.

The general word for measuring the change is assessment. Naturally, if we want to assess how much pupils have changed, we have to know exactly what they already **know** and what they can already **do**.

There are different types of assessment (or evaluation).

- Self-assessment (self - evaluation)
- Group assessment (group - evaluation)
- Individual assessment (evaluation)
- Combination of group and individual assessment
- The use of work samples, portfolios and projects.

During the first stage assessment and evaluation should be regarded as a playful, non-threatening process to track the learners' progress in developing their English language skills and competencies. Portfolios are particularly useful when working with young learners as they allow the collection of learners' work in one place motivating learners to keep a record of their work, and also help them to notice their advancement by the end of school year. The portfolios can also be used as an anchor to engage learners in communication using simple structures by allowing them to present their work.

If teachers want to find out how effective their teaching has been, or if they want to evaluate the learners' progress, then **tests** are used. Tests are conducted in class by the teacher. They measure the results of learners' performance. Teaching and testing always go hand-in-hand. Questions are often asked to check if the learners have understood what has been said. Equally, they may be asked to find out whether a particular point needs to be taught. We instinctively know why we ask a question: whether it is to teach or to test something.

Some major reasons for testing are:

- To diagnose learners' standard on arrival;
- To measure learners' progress;

- To find out how much pupils have learned;
- To find out the quality of learning, as well as of the teaching;
- To find out how many of the class have learned what they were supposed to learn;
- To motivate pupils;
- To show the teacher what to teach next.

There are different kinds of tests, such as:

- Proficiency tests
- Achievement tests
- Placement tests
- Diagnostic tests

We see **evaluation** as wider than testing. Testing may be a successful tool in evaluation, but we also think there are other criteria for assessing someone's performance.

Evaluation is not limited to numbers or just giving learners marks. Instead of trying to count or measure learner's ability to make useful contribution to the class, we can simply judge whether s/he makes a contribution or not, and sometimes we will have to justify, negotiate, and possibly modify our opinions.

With the evaluation, we are trying to help the learner to learn, so it is not an assessment, in fact, it is aid to learning. In other words, we can use assessment procedure to develop and improve, not only the learner, but also the teaching programme and even the school.

Guidelines for teaching materials, tools and resources

In order to achieve the targeted aims and learning outcomes and cover the topical content of the grade three syllabus teachers should select teaching materials from course book(s) of **beginner level**. These materials and aids should primarily be age-appropriate, which means that they should be dedicated to children and young learners.

Apart from this, teachers are encouraged to use supplementary materials to suit the learners' needs, that is, their background knowledge their interests, and motivation. Supplementary materials (video tapes, documentary films, drama activities, projects, contests and quizzes, and similar), may be used either within regular English classes, or within additional activities planned by the school curriculum (choice subjects, extra-curricular activities, and similar).

Pre-school & primary school online resources (Suggestions for teachers)

<http://www.education.com/worksheets/kindergarten/>

<http://www.starfall.com/n/level-k/index/load.htm?f>

https://www.youtube.com/watch?v=Tao7uuEFi_Y

<https://www.youtube.com/watch?v=UR-l3QI2nE>

<https://www.youtube.com/watch?v=d7klXv1KoBM>

<https://www.youtube.com/watch?v=BGa3AqeqRy0>

<https://www.youtube.com/watch?v=s5mGTToUtfng>

<https://www.youtube.com/watch?v=nfIgZFkh5ZA>
<https://www.youtube.com/watch?v=qOcM-L-Ss1o>
https://www.youtube.com/watch?v=d_zk--Iconw
<https://www.youtube.com/watch?v=UIaUoKRE4vc>
<https://www.youtube.com/watch?v=eBF9DxxAfkU>
<https://www.youtube.com/watch?v=ebkLEcINrro>
<http://www.learningchocolate.com/>
<https://learnenglishkids.britishcouncil.org>

FUSHA KURRIKULARE: ARTET

Kurrikulat lëndore/programet mësimore

Edukatë figurative

Edukatë muzikore

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Edukatë figurative

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Edukata figurative për klasën e tretë krijon bazën fillestare të formimit kreativ-artistik të nxënësve. Kjo lëndë në mënyrë të drejtpërdrejtë ofron komunikim dhe zhvillim të imagjinatës kreative tek nxënësit duke u ndërlidhur me fusha të tjera në reciprocitet. Roli i Edukatës figurative për këtë nivel shkollor konsiston në vazhdimin e zhvillimit të aftësive përceptuese dhe fitimin e shkathtësive ideo-kreative tek nxënësit, si shprehje e botës së tyre emocionale e përshkruese. Mësimi zhvillohet në mënyrë praktike dhe me konkretizim të mjeteve dhe materialeve të punës sipas teknikave realizuese. Procesi i mëimit kreativ tek nxënësit zhvillohet duke njohur koncepte, teknika dhe kuptime të gjuhës vizuale, për të zhvilluar aftësitë e nxënësve për komunikim më të suksesshëm artistik. Kjo lëndë, gjithashtu kontribuon në zhvillimin e imagjinatës së përgjithshme e kreative tek nxënësit. Me te, ndërlidhën përgjegjësitë e tyre në punë vetanake e grupe duke ndikuar në formimin e personalitetit të nxënësve, si individ të informuar, të shkathët, komunikues dhe me njohje kulturore të përgjithshme.

Qëllimi

Edukatë figurative për klasën e tretë të arsimit fillor, ka për qëllim që t'i aftësojë nxënësit për:

- Zgjerimin e njohurive të reja për të përjetuar të bukurën dhe artin vizual në rrethin ku jeton dhe më larg;
- Njohjen dhe përforcimin e pamjeve hapësinore në kontekst të përshkrimit të objekteve;
- Identifikimin e shkathtësive kreative të nxënësve dhe shtytjen vazhduese për krijimtari në fushën artistike;
- Zhvillimin e kreativitetit individual dhe thellimin e njohurive kërkimore për projekte të reja;
- Njohjen e koncepteve figurative dhe komunikimin sipas teknikave dhe mjeteve përdoruese;
- Plotësimin e njohurive shtesë në rrjedha mediale dhe zbatimin e tyre në praktikë.

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Nxënësit në klasën e tretë arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Artet, të shkallës së dytë të kurrikulës (Shkalla 2, klasa III, IV, V) në Kurrikulën Bërthamë për Klasën Parafillore dhe Arsimin Fillor.

Konceptet	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL-të)
Krijimtaria dhe performanca artistike		<p>RNF 1. Nxënësit krijojnë forma artistike duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të artit;</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësit krijojnë forma të ndryshme dy dhe tri dimensionale duke përdorur teknika të ndryshme figurative dhe aplikative;
		<p>-Të përdorë lloje të ndryshme të vijave për të krijuar figura e objekte; -Të vizatoj së paku një peizazh duke përdorur vijat dhe format e tyre; -Të vizatoj së paku një punim nga objektet (produktet) e ndryshme të natyrës së qetë; -Të skicoj hapësirat e mbrendshme dhe të vizatojë së paku 1 vizatim sipas objekteve të vendosura në: klasë, shtëpi, teatër, galeri, kinema etj.; -Të skicoj format e figurës së njeriut-portret; <i>-Njohja dhe përdorimi i mjeteve të vizatimit (laps, lapsa me ngjyrë, pastela, flomastera);</i></p>
		<p>-Të identifikojë ngjyrat elementare (e verdhë, e kuqe, e kaltër) dhe kombinimet e dyta; -Të përdorë ngjyra dhe teknika të ndryshme (pastel, akuarel) për ngjyrosjen e dy punimeve; -Të krijojë kontrast ngjyash në punime (kolazh, materiale) dhe të dallojë ndryshimet; -Të përdorë ngjyrat ngs lapsi dhe flomasterat dhe të përfitojë efekte tonike në punime; -Të kuptoj teknikën e akuarelit dhe të ngjyrosë së paku 2 punime (me ngjyra uji); <i>-Njohja dhe përdorimi praktik i mjeteve të ngjyrosjes në piktura (lapsa me ngjyrë, flomastera, ngjyra uji, pastel, penel etj).</i></p>
		<p>-Të përdorë materiale të ndryshme (të lehta) për krijime modelimi (3 dimensionale); -Të arrijë konkretizim modelimi të një figure gjeometrike me materiale të thjeshta modelimi; -Të krijojë figura simetrike me letër dhe materiale tjera praktike; -Të krijojë një figurë të adhuruar me plastelinë nga filmat e animuar sipas personazhit; <i>-Njohja dhe përdorimi i mjeteve të modelimit me mjete të lehta aplikuese (plastelinë, letra, tekstil,etj).</i></p>
<p>-Të kuptojë artin e shtypit të thjeshtë dhe riprodhimin grafik në shtypshkronjë, p.sh. vula,shtypi me kompjuter, libri, posteri, etj.</p>		

		<ul style="list-style-type: none"> -Të realizojë një ilustrim sipas një tregimi nga shkrimet, këngët ose filmi të zgjedhur; -Të vizatojë-disenjojë figurën e një heroji të pëlqyer; -Të njoh shenjat (në rrugë, në TV, etj.) dhe të disenjojë 1 punim duke shpjeguar kuptimin; -Njohja dhe përdorimi i mjeteve të shtypit dhe disenjimit (lapsa, flomastera, ngjyra, penel, letër, trëndësh, gomë, kompjuter, etj).
		RNF 2. Përmes përjetimit artistik, nxënësit njohin, vërejnë dhe tregojnë elementet kryesore të gjuhës artistike nga fusha përkatëse;
Gjuha dhe komunikimi artistik	Vizatimi nëpër kohë	<ul style="list-style-type: none"> -Të njoh llojet e vijave dhe vizatimeve, si dhe të kuptojë përdorimin e tyre në vepra arti; -Të kuptojë dhe shpjegojë rëndësinë e vizatimit dhe përdorimin në praktikë (p.sh. filmat e vizatuar, ilustrimet në libra, arkitektura e qytetit etj.); -Të tregoj së paku 1 vepër arti të artistëve të njohur nga realizimet me vizatim; -Të shikoj dhe të gjej iluzionin përceptues në pamjen arkitektonike të një qyteti;
	Llojet, teknikat dhe përdorimi i ngjyrave	<ul style="list-style-type: none"> -Të identifikojë dhe shpjegojë ngjyrat bazë dhe përzierjen e ngjyrave të dyta; -Të njoh mënyrën e përdorimit të ngjyrave të ujit, akualet, tempera; -Të krijoj një kolazh me format gjeometrike dhe të diskutojë mënyrën e realizimit; -Duke marrë shembuj të ndryshëm të komentojë përdorimin e ngjyrave në jetën e përditshme (flokët e individit, ngjyra e syve, veshjet, natyra sipas stinëve, makinat, ndërtesat; -Të bisedojë për natyrën, kopshtin e lodrave dhe shembuj të tjerë që ju lanë përshtypje dhe të shkëpusin një moment për të ngjyrosur. -Të përshkruaj me pak fjalë një vepër me kolor të pëlqyer;
	Format, modelimi dhe skulptura	<ul style="list-style-type: none"> -Të kuptojë dhe të tregojë vendosjen e artit në hapësirë, (p.sh. bustet, shtatore, objektet e vjetra, atrakcionet e ndryshme artistike, etj.) -Të kuptojë dhe dallojë format sipas madhësive dhe largësisë (perspektiva-iluzioni i pamjeve nga afër-larg, nga lart-poshtë dhe anasjelltas); -Të dallojë dhe demostrojë shembuj për përbërjen dhe strukturën e formave (të vrazhdëta, valore, të lëmuara, të forta, të buta, etj. - Të përshkruaj një tekst të shkurtër për një bust, shtatore apo vend historik të vizituar.

	Profesione dhe shkathtësi kreative	-Me teknikë të lirë kreative të realizojë 1 punim për profesionin e adhurar duke komentuar mënyrën e realizimit dhe përdorimin praktik; -Të shpjegojë mënyrën e ndërlidhjes së lëndëve me punimin e realizuar; -Të kuptojë rëndësinë e komunikimit me masën (p.sh. librat, gazetatat, reklama, shenjat, televizioni, celulari, lojërat, etj.)
		RNF 3 . Nxënësi identifikon relacionet e ndryshme të arteve në shoqëri dhe bisedon me spjegime për to; <ul style="list-style-type: none"> • vëren dhe identifikon lloje të ndryshme të arteve duke bërë krahasime dhe përshkrime të thjeshta; • kupton rëndësinë dhe llojet e institucioneve artistike; • njeh dhe emërton (se paku 6) krijues të njohur të gjinive e zhanreve të ndryshme të krijimtarisë artistike globale e kombëtare.
Relacioni art-shoqëri	Objekte dhe artefakte	-Të njoh dhe të komunikojë për objektet e rëndësishme të trashëgimisë kulturore (kombëtare dhe të kulturave të tjera); -Të kuptojë rëndësinë e vlerave të artit kombëtar dhe përkujdesin për to.
	Projekte dhe shembuj	-Të vizitojë objekte nga arkitektura dhe arti publik në qendrat të ndryshme dhe të krahasojë ato duke spjeguar rëndësinë dhe vlerën që kanë; -Të disenjojë një ide vizatimore për një park me lodra fëmijënore; -Të përdorë ornamente qilimash për një projekt ideor;
	Galeri dhe ekspozime	-Të njeh dhe kuptojë disa nga institucionet kulturoro-artistike në vend (muzeume, galeri, studio, vende arkeologjike, etj.); -Të përshkruajë punën e ekspozuar në një galeri qyteti, shkolle apo nga ekspozimi virtualo-elektronik në faqe interneti. -Të njoh së paku 4 krijues të njohur të fushave të ndryshme.
		RNF 4. Nxënësi/sja çmon dhe vlerëson në mënyrë të informuar dhe kritike krijimet artistike individuale dhe të të tjerëve ; <ul style="list-style-type: none"> • Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjate bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje, mimikë, me mjete shprehëse te tjera etj. • (çmon) dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetanake dhe të të tjerëve me fjalor

		shumë të thjeshtë(<i>p,sh ai/ajo pikturoi mirë, thjeshtë e pastër, më pëlqejnë ngjyrat që ka përdorur, nuk e ka vizatuar mirë formën e lules, etj</i>);
Çmuarja dhe vlerësimi estetiko-artistik	Analiza e punimeve	-Të bisedojë dhe të analizojë krijimet e realizuara në klasë dhe të artistëve të njohur (së paku 2 punime); -Të përshkruajë gojarisht punimet personale dhe të krahasojë me punimet tjera në klasë;
	Vlerësimi individual	-Të përjetojë në mënyrë individuale punimet nga veprat e njohura dhe të bëjë vlerësimin estetik sipas përjetimit (së paku 3 punime); -Të çmojë dhe vlerësojë imagjinatën kreative tek punimet vizuale;
	Përshkrimi i punimeve	-Të përshkruaj 3 punime nga artistë të njohur nga fusha të ndryshme, si: pikturë, skulpturë dhe disenj duke zgjerrë përshkrimin sipas përshtypjeve.

Udhëzime metodologjike

Metodologjia e mësimdhënies për Edukatë figurative është kompetencë dhe përgjegjësi e veçantë, bazuar në specifikën e përgatitjes së orës mësimore. Për realizim cilësor të mësimdhënies së kësaj lënde kërkohet përkushtim maksimal në aplikimin e metodave aktive dhe njohjen e aftësive psiko-fizike të nxënësve.

Në klasën e tretë kërkohet të përdorën metodat specifike të mësimit të koncepteve, shkathtësive dhe njohurive që duhet fituar nxënësi. Këtu kërkohet të përdorën forma kreative për të nxitur kërshtërinë dhe për të zhvilluar imagjinatën e të shprehurit artistik. Bashkëveprimi në punën praktike mësues-nxënës është i domosdoshëm. Zgjedhja e temave të përshtatura (nga përmbajtja programore) sipas stinëve, festave dhe momentit është shumë e rëndësishme dhe i motivon nxënësit për angazhim më të madh. Për zgjedhjen e këtyre temave, në radhë të parë duhet marrë parasysh mundësitë kreative të nxënësve dhe mjetet që kërkohen për realizim. Nxënësve, që në këtë nivel duhet t'u ofrojmë ndjenjën për ngjyrat, format, madhësitë dhe përciptimin logjik të tyre. Përmes imagjinatës kreative dhe përjetimit emocional nxisim ndjenjën për të bukurën dhe format e krijuara në punime.

Shkathtësitë motorike të krijimit në punime figurative arrihen me përkushtim të rregullt në njohjen dhe përshtatjen e aftësive psiko-fizike, zgjedhjen e temave të përshtatshme, ndërveprimin aktiv me nxënësit dhe zgjedhjen e formave të punës (individuale, në çifte, në grupe, mediale, etj.)

Edukata figurative në klasën e tretë mund të ndërlidhet me të gjitha lëndët mësimore si Gjuha shqipe; Matematika; Muzika; Punë dore etj. Në mënyrë të drejtëpërdrejtë ndërlidhet me kuptimet figurative nga natyra dhe objektet rrethuese. Përmes pamjeve figurative nxënësit njohin dhe mësojnë më lehtë konceptet e shkrim-leximit nga gjuha amtare, matematika, shkencat e natyrës, muzika, punë dore. Pamjet figurative nxisin kureshtjen dhe zhvillojnë kreativitetin më të madh në të gjitha lëndët duke parë format, ngjyrat dhe madhësitë e skicave, ilustrimeve dhe shkronjave në ato paraqitje.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Në sistemin arsimor çështjet ndërkurrikulare janë tema të rëndësishme përmes të cilave nxënësit fitojnë, zhvillojnë dhe përvetësojnë aftësi dhe njohuri specifike. Ata në këtë mënyrë përgatiten për jetën dhe punën e tyre në të ardhmen duke përballuar dhe tejkaluar më me lehtësi sfidat e jetës.

Çështjet ndërkurrikulare janë tema me të cilat vazhdimisht është ballafaquar shoqëria njerëzore, të cilat synojnë krijimin dhe kultivimin e disa vlerave shoqërore, humane e njerëzore, të cilat kontribuojnë në formimin e identitetit dhe personalitetit individual dhe të pavarur të nxënësve.

Çështjet ndërkurrikulare janë çështje që domosdo janë të ndërlidhura me rezultatet e fushave ku integrohen dhe kontribuojnë të gjitha fushat kurrikulare në forma të ndryshme duke përfshirë edhe e fushën e arteve me lëndët e saj, e cila i ndihmon nxënësit të njohin, kuptojnë dhe të interpretojnë më mirë botën, ngjarjet, proceset, marrëdhëniet në shoqëri dhe të rritin lidhjen e arsimit me jetën dhe me interesat e saj.

Nga mësimdhënësi kërkohet që në fazën e planifikimit të analizojë rezultatet e fushës, temat dhe njësitë mësimore dhe të parashoh se me cilat çështje ndërkurrikulare ndërlidhen. Në këtë mënyrë sigurohet trajtimi sa më i mirë i këtyre çështjeve duke marrë parasysh edhe mësimdhënien e integruar.

Çështjet ndërkurrikulare që mund të ndërlidhen dhe trajtohen në lëndën e artit figurativ janë:

- Edukimi për media,
- Edukimi për paqë
- Edukimi për qytetari demokratike
- Globalizimi dhe ndërvarësia
- Të drejtat dhe liritë e njeriut
- Zhvillimi i qëndrueshëm

Edukimi për media

Edukimi për përdorimin e medias është një imperativ i kohës për nxënësit, e cila u siguron informacione për zgjerimin e njohurive të tyre mbi zhvillimet historike të artit, autorë, vepra arti, teori dhe probleme artistike, duke zhvilluar dhe kultivuar shkathtësinë dhe kulturën hulumtuese për trajtimin e problemeve të caktuara. Gjithashtu mediumet mund të përdorin edhe për krijime artistike dhe prezantimin e projekteve të ndryshme artistike.

Edukimi për paqë

Nxënësit në lëndën e artit mund të trajtojnë dhe realizojnë tema që kanë të bëjnë me paqen, respektimin e dinjitetit njerëzor, diversitetit kulturor, toleranca, humanizmi, harmonia dhe bashkëjetesa.

Edukimi për qytetari demokratike

Në temën Edukimi për qytetari demokratike përmes artit nxënësit mund të trajtojnë tema për qytetërimet dhe demokracinë dhe në këtë formë të formojnë identitetin e tyre qytetar e kulturor, si qytetar aktiv për mirqenien e tyre dhe të komunitetit.

Globalizimi dhe ndërvarësia

Nxënësit trajtojnë tema që kanë të bëjnë me epokën e globalizimit në sfera të ndryshme shoqërore si në art, kulturë, ekonomi, arsim etj. Dhe ndërvarësia dhe raporti i zhvillimeve të kulturave të ndryshme shoqërore, duke krijuar një këndvështrim pozitiv e pranues ndaj këtyre përvojave dhe kulturave.

Të drejtat dhe liritë e njeriut

Nxënësit trajtojnë përmes artit tema që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë e njeriut, duke kultivuar kulturën e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut pa marrë parasyshë, gjininë,

racën, nacionalitetin etj. P.sh koncepti i ngjyrave pa dallim gjinor, mund te trajtohet që në këtë fazë sapo të njihen nxënësit me ngjyrat etj.

Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Zhvillimi i qëndrueshëm është një proces i cili i përgatitë nxënësit me aftësi të qëndrueshme që garanton mundësitë për një jetë më të mirë. Nxënësit duhet të aftësohen të zbulojnë sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm në këndvështrime të ndryshme, që kanë të bëjnë me ndikimet e veprimtarisë së njeriut mbi shoqërinë, në aspektin kulturor-artistik, social, ekonomik dhe mjedisor. Duke përforur materiae recilkuese, por edhe duke inkurajuar fëmijët që të mbrojnë ambientin, letrën, ngyrat duke i përdorur në mënyrë ekonomike, ne i edukojmë ata për një mjedis të shëndoshë. Tema e mjedisit mund të jetë edhe objekt i trajtimit kreativ ne punimet e tyre.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është proces i grumbullimit sistematik, cilësor e sasior të informatave të arritjes së nxënësve gjatë procesit të nxënies. Vlerësimi përfshinë veprimtarinë aktive të mësimdhënësit dhe kërkon vëmendje të shtuar për ndjekjen e zhvillimit gradual në arritshmërinë e rezultateve të të nxënësve në nivel klase e shkolle dhe zotërimin e kompetencave sipas PM. Mësimdhënësi gjatë vlerësimit duhet të ketë parasysh përmbajtjen programore në arritjen e rezultateve mësimore dhe kompetencave të përcaktuara për këtë nivel, po ashtu, metodologjia e mësimdhënies dhe nxënies është e lidhur ngushtë me procesin e vlerësimit të nxënësve ngase është një element i pranishëm në çdo veprimtari mësimore.

Ky proces vlerësimi shtrihet që nga vlerësimi dhe vetëvlerësimi i punimeve të nxënësve të realizuara me teknika të larmishme artistike, portofoli me punë artistike, prezantimi me gojë dhe me shkrim, testimi, pjesëmarrja në një projekt kurrikular etj.

Vlerësimi në artin figurativ, mbështetet në parimin e individualizimit, ngase arritjet janë më shumë individuale, ku çdo nxënës ka predispozita dhe prirje të ndryshme për format e shprehjes artistike.

Inkurajimi, imagjinata, shprehja origjinale, krijuese, interesimi, përjetimi artistik, interpretimi dhe prezantimi i punëve artistike janë forma, të cilat ndihmojnë në vlerësimin e punës krijuese të nxënësve në artet figurative.

Gjithashtu, pjesëmarrja individuale dhe në grupe, në aktivitetet të ndryshme artistike, që organizohen në klasë, shkollë dhe në komunitet, janë pjesë e procesit të vlerësimit.

Vlersimi individual bëhet në funksion të matjes së kompetencave artistike të caktuara, që arrin të zhvillojë nxënësi gjatë procesit mësimor, vetëm ose në grup, përmes veprimtarisë praktike, d.m.th., përmes krijimit, vëzhgimit, dhe analizës së veprave të artit etj.

Portofoli me krijimet, shkrimet, prezantimet dhe testimi janë një mundësi objektive e vlerësimit të nxënësit, pasi i përgjigjet edhe vlerësimit sipas kompetencave të lëndës së artit figurativ.

Qëllimet e vlerësimit:

- *Të identifikohet përparimi i nxënësve dhe t'u ofrohen të dhëna të mjaftushme.*
- *Të motivohen nxënësit për punë*
- *Të sigurohen informacione për shkallën e arritshmërisë së kompetencave*
- *Të diagnostikojnë pikat e dobëta dhe të forta tek nxënësit.*
- *Të përmirësohen nxënia dhe mësimdhënia*
- *Të japin detyra sipas aftësive individuale në përputhje me nivelin e nxënësve.*
- *Të përzgjedhin metoda të përshtatshme gjatë mësimdhënies, bazuar në nivelin e klasës.*
- *Të sigurohen informacione për zhvillimin e nxënësve për orientimin e tyre të ardhshëm*

Format dhe instrumentet e ndryshme të vlerësimit

Gjatë procesit të vlerësimit sugjerohet që mësimdhënësit të përdorin forma dhe instrumente të ndryshme vlerësimi, duke u ofruar nxënësve jo vetëm kritere të shkruara, por edhe lloje të tjera të vlerësimit, për të kuptuar në mënyrë konkrete arritjet të cilat ata i synojnë. Instrumentet për vlerësim gjithmonë duhet të jenë të përshtatshme, varësisht prej qëllimit të vlerësimit. Forma dhe lloji i vlerësimit dhe veçanërisht mënyra në të cilën rezultatet raportohen, gjithmonë duhet të reflektojnë qëllimin e vlerësimit. Mënyra e ndërtimit të vlerësimit gjithmonë duhet të jetë transparente dhe e drejtë. Vlerësimi gjithmonë duhet të zbatohet me standardet më të larta etike. Vlerësimi i nxënësve duhet të jetë motivues dhe objektiv.

Metodat e vlerësimit

Vlerësimi verbal - përdorimi i pyetjeve të shkurtra, biseda rreth materialit mësimor apo një detyre konkrete, duke diskutuar me nxënës të veçantë, grupe apo me gjithë klasën, duke dëgjuar diskutimet që bëjnë nxënësit me njëri - tjetrin për një koncept, mbi njohuri të arteve figurative, vepër apo detyrë artistike etj.

Vlerësimi me shkrim ose testimi - detyra të veçanta për grupe nxënësish, teste të shkurtra për një koncept, temë apo dhe një grup temash, për një ese si dhe testime për një kohë të caktuar, semestrale apo vjetore.

Vlerësimi i detyrave të realizuara - vëzhgimi hap pas hapi i detyrave të artit, që nga idea deri tek organizimi dhe realizimi si p.sh: demonstrimi i arritjeve në punë praktike (realizimi i punëve dy dhe tredimensionale, interesimi për ndjekjen e jetës artistike në komunitet, pasioni për artin, vlerësimi dhe përkushtimi ndaj kësaj lënde etj).

Vlerësimi i projekteve të ndryshme - bashkëpunimi i nxënësve në një projekt të përbashkët në shkollë apo gjetiu.

Vlerësimi i punëve artistike - marrja pjesë në veprimtari të ndryshme artistike që organizon shkolla etj. Pjesëmarrja në veprimtari kombëtare si: konkurset, ekspozitat në shkallë vendi apo më gjerë.

Vlerësimi përmes portofolit - portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor. Ai mund të përmbajë detyra tematike

(ese), krijime të ndryshme të realizuara gjatë vitit shkollor që mund të jenë krijime në pikturë, skulpturë (plastelinë), disenj, realizim me kompjuter, grafikë, fotografi, etj.

Instrumentet e procesit të vlerësimit

- Testi i strukturuar me gojë ose me shkrim;
- Dosja e punimeve;
- Realizimi i projekteve – ekspozitave;

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Përzgjedhja dhe përdorimi i mjeteve didaktike e mësimore është pjesë e pandashme e procesit të mësimdhënies, dhe ka një rëndësi të veçantë në arritjen dhe realizimin e kompetencave. Këto mjete janë në shërbim të demonstrimit dhe të konkretizimit të temave dhe njësive mësimore të trajtuara në lëndën e artit dhe të njejtat duhet të jenë shumë efikase, të prekshme dhe praktike për nxënësit.

Teknologjia është një nga mjetet me përdorim të gjerë në lëndën e artit figurativ duke ndihmuar nxënësit të hulumtojnë dhe njohin vepra arti të ndryshme, objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të dizajnit, etj. Shkolla si institucion arsimor, duhet të siguroj dhe ofroj kushte dhe mundësi tekniko-teknologjike adekuate apo alternative në realizimin dhe arritjen e kompetencave të planprogrameve të lëndëve të caktuara, në këtë rast edhe të lëndës së artit.

Në këtë formë nxënësve u krijon mundësinë të demonstrojnë apo prezantojnë me anë të medimeve teknologjike detyra dhe projekte të ndryshme, duke krijuar tipin studiues të nxënësve në lëndën e artit.

Mësimdhënësi nxit interesimin e nxënësve për veprimtari dhe trajtim të temave të artit duke përdorur një fjalor të pasur të gjuhës artistike figurative me fjalë dhe fjali të qarta, të sakta, kuptimore e konceptuale.

Mësimdhënësi nxit zgjërimin e njohurive mbi artin tek nxënësit duke i motivuar ata që të përdorin burime, materiale dhe tekste të përshtatshme për moshën dhe mundësitë sipas nivelit të tyre.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- **Materiale tekstuale:** *teksti shkollor, fletore e punës, katalogje arti, albume, udhëzues profesional, fjalor, gazeta, revista, materiale pedagogjike, enciklopedi etj.;*
- **Mjete vizuale – figurative:** *tabelë shkrimi, fotografi, piktura, modele, makete, vazo, riprodhime të veprave të artit dhe postera, diagrame, mjete grafike etj.;*
- **Mjete audiovizuale – figurative-dëgjimore:** *televizori, filmi, videoprojektori, kasetavideo, kompjuteri, interneti, teleteksti, CD-të, DVD, e-mail-i;*
- **Mjedisi mësimor:** *(klasa, ateleja, kabinet, natyra, galeria, muzeu etj.)*
Burime online <https://www.artsattack.com/>

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Edukatë muzikore

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Kontaktet e para me muzikën fëmija i merr që në moshë të hershme, fillimisht në rrethin familjar e pastaj edhe përmes edukimit muzikor në institucione parashkollore. Ata vazhdimisht këndojnë, dëgjojnë muzikë në rrethin ku jetojnë, dëgjojnë zërat në natyrë, onomatopetë e ndryshme ritmike dhe melodike etj. Këto përvoja të hershme mund të përdoren për edukimin muzikor në shkollimin fillor duke i konkretizuar këto përjetime nga jeta e përditshme me lojëra, këngë, ligjërime ritmike, lëvizje etj. Përmes aktivitetit muzikor tek fëmijët sjellim gëzim, hare, relaksim, entuziazëm dhe në këtë mënyrë muzika ndikon direkt në pasurimin emocional të tyre, i fisnikëron ata dhe njëkohësisht ndikojmë në zhvillimin e dispozitave të ndonjë prej aftësive muzikore për të cilën mund të ketë pre-dispozitë.

Qëllimet e lëndës

Lënda edukatë muzikore në klasën e tretë ka për qëllim që të vazhdojë të nxisë nxënësit ta duan muzikën si veprimtari dhe që përmes pjesëmarrjes së tyre aktive në aktivitetet muzikore në klasë të zhvillojë më tutje prirjet muzikore të nxënësve (për këndim, luajtje në instrumente ose reagim ndaj muzikës dhe krijim muzikor).

Mësimi në shkollë bëhet më atraktiv dhe më i kënaqshëm përmes aktiviteteve të ndryshme muzikore-artitike në të cilat nxënësit aktivisht marrin pjesë. Synimi kryesor në këtë klasë është që nxënësit të aftësohen të përjetojnë dhe performojnë saktë dhe me kreativitet vepra artistike muzikore (këngë, pjesë instrumentale etj) të përshtatshme për moshën e tyre dhe të zhvillojnë aftësinë për dëgjim aktiv të muzikës. Krahas kësaj nxënësit marrin dhe informacione për krijues, vepra, performues, ngjarje dhe njohin disa nga konceptet bazike muzikore. Aktivitetet muzikore në klasë (këndimi, luajtja në instrument, dëgjimi i muzikës, krijimi dhe të shprehurit kreativ) nxisin zhvillimin emocional intelektual, imagjinatën, vëmendjen, interesimin për kreativitet etj.

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Konceptet	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL-të)
		RNF 1. Nxënësi merr pjesë në aktivitete të ndryshme artistike sipas interesimit dhe prirjes individuale
Krijimtaria dhe performanca artistike	1. Këngët	<ul style="list-style-type: none"> • Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notcionit simbolik (grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj). • Shoqëronë këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë simbas instruksioneve të mësidhënësit dhe në mënyrë kreative
	2. Lojërat muzikore	<ul style="list-style-type: none"> • Luan lojëra të thjeshta muzikore të shoqëruara me këngë të cilat kanë gjuhën shprehëse të përshtatshme me fjalorin e moshës së tyre, të përcjellura me lëvizje trupore, e me vegla muzikore femijerore dhe që trajtojnë tema të ndryshme por edhe elemente didaktike të gjuhës artistike muzikore (ritmi, melodia, vetitë e tingullit muzikor etj) • Luan lojëra të ndryshme ku sinkretizohet fjala, muzika, mimika, lëvizja, ana vizuale etj (tematika e lojërave përshtatet me tematikat nga fushat e tjera mësimore për këtë klasë)
	3. Krijimet muzikore	<ul style="list-style-type: none"> • Improvizon në ritme të ndryshme me ze dhe instrumete ritmike • Ritmizon në mënyrë kreative vargjet, poezitë, gjeegjezat etj. • Realizon plotësimet muzikore (përfundimin e një melodie, pyetje-pergjege muzikore etj) • Këndon ose luan në instrumente fëmijërore ndonjë krijim origjinal
		RNF2. Përmes përceptimit dhe përjetimit artistik nxënësit njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse

Gjuha dhe komunikimi artistik	Elementet bazike të gjuhës artistike	<ul style="list-style-type: none"> • Përjeton dhe dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur-mol) ne këngët, lojërat dhe veprat muzikore qe ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë • Njeh notacionin grafik për disa nga vetitë themelore të tingullit muzikor, (lartësi dhe gjatësi të tingullore) • Dallon dhe njeh disa dukuri muzikore ritmike e melodike në këngët e kënduara dhe në veprat e dëgjuara
		<p>RNF3. Nxënësi dallon relacionet e ndryshme në mes të arteve dhe shoqërisë</p> <ul style="list-style-type: none"> • vëren dhe identifikon lloje të ndryshme të arteve (p.sh muzikën vokale, instrumentale, portreti, peisazhi etj) • identifikon llojet e institucioneve artistike (galeri, teatër, muze, salle koncertale etj) • emërton disa (se paku 4 krijues, interpret të njohur të gjinive e zhanreve të ndryshme të krijimtarisë artistike globale e kombëtare muzikore
Artet dhe shoqëria	Llojet e muzikës	<ul style="list-style-type: none"> • dallon lloje të ndryshme të muzikës në shoqëri përmes dëgjimit muzikor (p.sh muzike per vallëzim, muzike per film (vizatimor), muzike për fëmijë, muzikë për raste të ndryshme, muzikë festive etj) • Identifikon muzikën e përshtatshme për ngjarjet dhe situatat e ndryshme
	Instrumentet muzikore	<ul style="list-style-type: none"> • Dallon ngjyrën tingëllore të instrumenteve muzikore (popullore dhe klasike) përmes dëgjimit të veprave muzikore të përshtatshme për moshën e tyre • Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizuelisht • Krijon instrumente muzikore ritmike me materiale recikluuese dhe organike (marakas me oriz, miser, dajre te vogla etj) • Dallon instrumentet per nga materiali ndertues, burimi tingellor (instrumentet te drunjeta, te tunxhit, frymore me harqe etj) , menyra e interpretimit, ansambleeve qe u perkasin etj
	Krijuesit dhe performuesit	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon ndonjë figurë markante nga krijuesit dhe performuesit artistike boterore dhe lokale

		RNF 4. Nxënësit mësojnë të çmojnë dhe vlerësojnë artin
Çmuarja dhe vlerësimi estetik-artistik	Veprat artistike Ngjarjet artistike	<ul style="list-style-type: none"> • Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjate bisedës dhe vrojtimit , me lëvizje,mimike, me mjete shprehëse te tjera artistike etj. • Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetanake dhe të të tjerëve me fjalor e terma adekuate • Krijon shprehi për dëgjim te vazhdueshem te veprave muzikore dhe per muzikim • Përshkruan dhe komenton (me forma të ndryshme shprehëse: me gojë, me shkrim, me shprehje figurative, etj) ndonjë ngjarje muzikore artistike të përjetuar në familje, në shkolle, koncert, nga TV etj

Udhëzimet metodologjike

Përzgjedhja e metodave mësimore bëhet nga mësimdhënësit në përputhje me kurrikulën. E rëndësishme është që mësimdhënësit duhet të krijojnë një mjedis mësimi i cili do t'i nxisë dhe do t'i ndihmojë fëmijët për të zbuluar dhe për të zhvilluar aftësitë dhe prirjet e tyre artistike. Tek fëmijët e klasës së tretë sikurse në klasën paraprake (klasa e dytë) këngët dhe lojërat muzikore dominojnë në mësimin e muzikës. Këngët mësohen sipas veshit (me imitim) dhe mund të fillojë gradualisht parqitja e notacionit grafik me të cilin identifikohen lartësitë dhe gjatësitë tingëllore. Tematika e këngëve dhe lojërave duhet të jenë në përshtatje me moshën dhe aftësitë e tyre performuese (ambitusi, vështirësia e tekstit, e ritmit dhe posaçërisht përmbajtja tekstuale me karakter edukativ dhe didaktik. Këngët duhet të jenë të shkurtëra, të thjeshta dhe kryesisht të zhanrit të muzikës për fëmijë por edhe ato popullore e artistike të thjeshta dhe të përshtatshme mund të përdoren në këtë klasë.

Përmbajtja tematike mund të korrespondojë me temat që trajtohen nga fushat e tjera mësimore, por edhe me çështjet e ndryshme ndërkurrikulare. Është e nevojshme që përgjatë këndimit të aplikojmë qëndrimin drejt, këndimin me emocion, shqiptimin e saktë të tekstit, synimin që të këndohet në intonacion sa më të saktë. Fëmijët inkurajohen të këndojë vetëm por edhe në grup, të krijojnë efekte të veçanta tingujsh (imitimin e zërave të shkokëve, të instrumenteve të ndryshme), duke përdorur zërin, shkopinjë, shuplaka ose instrumente, të ndjekin ndryshimet e ritmit etj.

Për edukimin e ndjenjës ritmike të fëmijëve duhet t'u demonstrojmë në formë konkrete dukurinë e ritmit se si përjetohet dhe me pastaj t'a zbatojmë atë në praktikë. P.sh. Dukuritë nga natyra dhe mjedisi, p.sh: të rrahurit e orës tik- tak, imitimi i trenit, rënia e ziles, rrahja e çekanit, rrahja e pulsit të dorës, rrahja e këmbanës, rrahja e daulles në një marsh etj.) Ligjërimet ritmike duke i shoqëruar me lëvizje ritmike ose fjalë të ndryshme të ndara në rrokje, duke i shoqëruar me duar trokitje, me shkopinjë etj. Është e këshillueshme që mësuarja e ushtrimeve me elemente ritmike të bëhet në shoqërimin e këngëve dhe lojërave fëmijërore.

Puna me instrumentet muzikore shton interesin për aktivitetet muzikore si dhe ndihmon drejt në edukimin e ndjenjës ritmike apo melodike. Në këtë mënyrë krijojmë modele të thjeshta ritmike; rrahje me pëllëmbë, me vegla, me goditje, krijojmë instrumente prej materialeve recikluese me të cilat pastaj i shoqërojmë këngët, ligjërimet por luajmë edhe ritme e melodi. Në këtë pjesë inkuadrohen edhe të mësuarit për disa nga konceptet bazike muzikore (ritmi, gjatësitë e ndryshme tingëllore, raportet ritëm-metër etk) shoqëruar edhe me simbolet grafike që paraqesin ato koncepte.

Dëgjimi është mënyra kryesore nëpërmjet të cilës fëmija vihet në marrëdhënie me muzikën. Përmes dëgjimit ata shprehin emocione që sjell kënga, vepra instrumentale etj. Mësuesi duhet të kultivojë ndjenjën e të dëgjuarit të zërit të tij përderisa fëmija këndon këngën, të shoqëroj muzikën me lëvizje të përshtatshme (duke vallëzuar balet, vals, marsh etj.). Dëgjimi zhvillon njëkohësisht dhe aftësinë për komentimin e pjesëve instrumentale që ata dëgjojnë me një fjalor të thjeshtë e të përshtatshëm e adekuat. Mësuesi mund të përdorë metodën e krahasimit ku

krahasohet një valle me një marsh, një ninulë me një muzikë vallëzimi , krahasimi i ngjyrës së zërave të shokëve , të kafshëve , instrumenteve etj. Pjesët që do të dëgjojnë kjo moshë duhet të jenë të përzgjedhura me kujdes , të jenë të thjeshta në përmbajtje muzikore dhe të zgjasin 2 – 4 minuta.

Në aspektin e ndërlidhjes dhe të integritit, muzika mund të jetë pjesë e cdo teme të realizuar në klasën e tretë nga fusha të ndryshme. P.sh në matematikë, krahasimi i thyesave me ndarjen e njesise për numëri (nota katërshe, gjysmë, tetëshe); dukuritë e ndryshme muzikore në shkencat e natyrës(si prodhohet zeri, si përcohet zëri etj); Ushtrimet gjatë orëve të edukatës fizike(ecja, vrap, aktivitetet e ndryshme) mund të shoqërohen me muzikë ritmike. Pra në cdo temë apo njësi mund të inkuadrohet muzika përmes dëgjimit ose këndimit për të bërë mësimin më interesant për fëmijët e kësaj moshë. Muzika mund të jetë edhe mjet i mirë për relaksim gjatë pushimeve të shkurtëra. Muzika relaksuese e qetë i qetëson nxënësit dhe ndikon që të jenë të përgaditur për mësimin e radhës. Shumë aktivitete rutinë mund të sinjalizohen përmes këngëve të ndryshme ose shembujve adekuatë muzikorë për dëgjim.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Nga perspektiva e fushës –artet,në klasën e tretë mund të trajtohen edhe një varg çështjesh ndërkurrikulare që kanë të bëjnë me zhvillimin e qëndrueshëm, njohjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve, çështjet e barazisë gjinore, çështjet kulturore dhe ndërkulturore, parandalimi dhe luftimi i dukurive negative shoqërore etj. P.sh trajtimi i rëndësisë së barabartë dhe bashkëpunimit ndërmjet zërave të dy gjinive në muzikë, trajtimi i profesioneve artistike pa dallim gjinor, fetar, racor etj

Globalizimi dhe ndërvarësia

Nga perspektiva e arteve, vetë veprimtaritë artistike grupore e trajtojnë këtë temë, ngase p.sh kur duhet të realizohet një mural, mozaik, kolazh, ose maketë grupore, të gjithë pjesëmarrësit e kuptojnë që pa bashkëveprimin e secilit nuk mund të realizohet tërësia e përbashkët. Muzikimi në ansambël, kor, orkestër realizohet vetëm duke respektuar bashkëveprimin dhe ndërvarësinë.

Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm, çështjet e realizimit të së drejtës për të jetuar në mjedis të shëndoshë dhe në mirëqenie sociale bazuar në konventat ndërkombëtare mund të jenë objekt trajtimi i punës kreative të fëmijëve edhe në këtë moshë.

Përdorimi i shprehjes artistike për të trajtuar të drejtat themelore të fëmijës për shkollim, për liri e jetë të dinjitetshme mund të realizohet shumë mirë përmes këngëve, punimeve kreative etj. Përdorimi i shprehjes artistike për të trajtuar disa nga temat e zhvillimit të qëndrueshëm (mbrojtja e ambientit, hapësirave, rregullit në klasë, në shtëpi në familje etj) bëhet p.sh duke

njohur dhe përdorur materiale recikluese për të krijuar art por në të njëjtën kohë duke zhvilluar kujdes ndaj letrës, drurit, materialeve në klasë dhe ambientit të shkollës etj. Cështjet si mbrojtja e ambientit, lumenjve, planetit tokë në përgjithësi mund të inspirojë nxënësit për të përdorur muzikën, këngën për të përcuar mesazhet e duhura.

Udhëzimet për vlerësim

Vlerësimi tek nxënësit është që të zhvilloj kreativitetin e fëmijeve dhe të nxis e ti motivojë ata, por mund të shpërblehen me vlerësime simbolike yll, zemër, diell ata që dallohen me kreativitet dhe aktivitet artistik. Që në këtë moshë është mirë që fëmijët të nxiten dhe të ndihmohen që të bëjnë vlerësimin kritik për performancën vetanake dhe të bashkëmoshatareëv të klasës duke u nxitur me pyetjet : Si ka/ke kënduar, si ka/ke vallëzuar, si ka/ke vizatuar apo modeluar etj)

Vlerësohet cdo dimension (këndimi, njohja e elementeve muzikore, njohurite për temat nga degjimet muzikore, vepra, autori, instrumenti etj) për secilin nxënës me instrumentet e vlerësimit që ka mësimdhënësi në dispozicion dhe pastaj përmbledhet nota nga të gjitha verimtaritë. Listat e kontrollit për këndimin, luajtjen në instrumente dhe dëgjimet muzikore, mund të plotësohen edhe me testet muzikore me dëgjim, teste të thjeshta muzikore për elementet muzikore (diktat) por edhe teste me shkrim, prezantimet individuale dhe grupore, etj.

Materialët dhe burimet mësimore

Përzgjedhja dhe përdorimi i mjeteve didaktike e mësimore është pjesë e pandashme e procesit të mësimdhënies, dhe ka një rëndësi të veçantë në arritjen dhe realizimin e kompetencave. Këto mjete janë në shërbim të demonstrimit dhe konkretizimit të temave dhe njësive mësimore të trajtuara në lëndën e edukatës muzikore dhe ato duhet të jenë shumë efikase, të prekshme dhe praktike për nxënësit.

Shkolla si institucion arsimor, duhet të siguroj dhe ofrojë kushte dhe mundësitë tekniko-teknologjike adekuate apo alternative në realizimin dhe arritjen e kompetencave të parapara dhe rezultateve të nxënësve nga lënda e muzikës. Në këtë formë krijohet mundësia e demonstrimit dhe prezantimit të materialit muzikor të përzgjedhur nga mësimdhënësi për dëgjim.

Mësimdhënësi nxit interesimin e nxënësve për veprimtari muzikore dhe zgjerimin e njohurive tek nxënësit duke i motivuar që të përdorin burime, materialeve dhe tekste (Libra) të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- Materiale tekstuale: *teksti shkollor, fletore e punës, katalogë arti, albume, udhëzues profesionalë, fjalorë, gazeta, revista, materiale pedagogjike, enciklopedi etj.;*
- Mjete auditive-dëgjimore: *radioja, magnetofoni, telefoni, kasetofoni etj.;*

- Mjete audiovizuale – televizori, filmi, videoprojektori, kasetavideo, kompjuteri, interneti, teleteksti, CD-të, DVD, e-mail-i;
- Instrumentet muzikore për fëmijë (shkollore, popullore, të Orfit ose të krijuara nga nxënësit me material recikluese)

<https://www.pinterest.com/pin/34902965838806956/>

<http://www.kinderart.com/teachers/9instruments.shtml>

Burime online

<http://www.classicsforkids.com/>

<http://colorinmypiano.com/2010/03/19/early-childhood-online-resources/>

<https://www.preschoolprodigies.com/>

<http://www.sphinxkids.org/>

Video me muzike klasike per femije

https://www.youtube.com/watch?v=1hMjxnwig0o&list=PL3WK__yMF5c6fF5aQNDxY_wEKERIeEnGY

http://www.bbc.co.uk/northernireland/schools/4_11/music/mm/

http://www.bbc.co.uk/northernireland/schools/4_11/music/mm/teachers/lessonplans.shtml

FUSHA KURRIKULARE: MATEMATIKË

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Matematikë

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Matematikë

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Të mësuarit e matematikës në klasën tretë është vazhdimësi e përvetësimit të koncepteve elementare të matematikës që plotëson bazën për zotërimin e shprehive dhe shkathtësive matematikore në të ardhmen dhe i përgatit nxënësit në zhvillimin intelektual dhe formimin e personalitetit për të qenë të suksesshëm në përballje me sfidat e jetës dhe integritit në shoqëri. Nxënësit e kësaj klase janë të pajisur me informacione elementare matematike dhe me përvoja të ndryshme që lidhën me mjedisin ku ata jetojnë, andaj është e rëndësishme që edhe programi i matematikës duhet të sigurojë një shumëllojshmëri mundësish të të nxënit përmes materialeve të mira mësimore, me metodologji të mësimdhënies dhe me angazhim të përhershëm për zhvillimin e aftësive të tij.

Në klasën e tretë matematika zhvillohet si pjesë e integruar e aktiviteteve të përditshme me një lidhje të fortë me gjuhën, artin, muzikën dhe përmes aktiviteteve në mënyrë që nxënësit argëtohen dhe arsimohen përmes matematikës. Nëse situatat matematikore janë të lidhura me jetën e përditshme të nxënësve, atëherë ato bëjnë të mundur që nxënësi të zbatojnë atë që e di dhe të zhvillojnë njohuri të reja për matematikën.

Përmes programit të matematikës arrihet qëllimi i të mësuarit e lëndës që i shërben:

- nxënësit në zhvillimin e kompetencave kryesore të të nxënit gjatë gjithë jetës dhe të kompetencave të fushës së matematikës, në mënyrë që ai në të ardhmen të jetë qytetar i suksesshëm,
- mësuesit për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe arritjet e nxënësve në klasë dhe jashtë saj,
- prindit për njohjen e rezultateve të të nxënit dhe kriteret e vlerësimit në periudha të caktuara kohore për fëmijën e tij ,
- hartuesit të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.

Po ashtu rezultatet e të nxënit të lëndës për tema mësimore për përmbajtje të cilat krijojnë kushte që nxënësi të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në funksion të kompetencave të fushës dhe kompetencave kryesore dhe përmes udhëzime metodologjike të mësimdhënies si kusht për zbatimin e programit, për arritjen e kompetencave nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes, udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare për kontributin e matematikës në shoqëri dhe në jetën e përditshme, njëkohësisht udhëzime për vlerësimin e arritjes së nxënësve të klasës së tretë, si njëra ndër komponent thelbësore për përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe procesit të të nxënit dhe udhëzime për materiale didaktike dhe burimet e mjetet mësimore, të cilat e plotësojnë në tërësi programin e matematikës.

Qëllimi

Të mësuarit e matematikës në klasën e tretë ka për qëllim zhvillimin intelektual të çdo nxënësi, ushtrimin e rregullave themelore, kultivimin e vlerave si dhe përgatitjen për klasat në vijim, përkatësisht shkallën e tretë.

Programi i matematikës ka për qëllim të pajisë nxënësit me modelet e të menduarit matematik, me idetë bazë dhe strukturat matematikore, si dhe t'u zhvillojë atyre aftësitë llogaritëse dhe të zgjidhjes së problemave në jetën e përditshme.

Zhvillimi i matematikës kryesisht fokusohet në:

- zhvillimin e të kuptuarit për mbledhje dhe zbritje, shumëzim dhe pjesëtim si dhe strategjitë për gjetjen e vlerës së shprehjeve numerike
- zhvillimin e të kuptuarit të marrëdhënieve ndërmjet numrave dhe vend- vlerës duke përfshirë grupimin në dhjetëshe dhe njëshe;
- zhvillimin e të kuptuarit të matjes, matjen e gjatësisë;
- arsyetimin në lidhje me atributet dhe kompozimi dhe dekompozimi i formave gjeometrike;
- grumbullimin e informatave dhe përpunimin e tyre.

Qëllimi i lëndës së matematikës në klasën e tretë është *Formimi matematik* i cili bëhet përmes:

- të nxënimit të integruar dhe në kontekstin e jetës së përditshme
- të nxënimit nëpërmjet përvetësimit të koncepteve elementare të matematikës.

Temat dhe rezultatet e të nxënimit

Përvetësimi i përmbajtjeve programore nga nxënësi demonstron si **njohuri** relevante që atij i parashtrohen në raport me moshën, **shkathtësitë** që i demonstroi nxënësi, ku përfshihen aftësitë, zotësitë, teknikat dhe metodat për zbatimin e njohurive në arritjen e rezultateve të planifikuara për këtë klasë.

Në lëndën e matematikës për klasën e tretë zhvillohen dhe përvetësohen kryesisht këto koncepte të përgjithshme matematikore:

- numrat, algjebra dhe funksioni;
- forma, hapësira, matjet dhe gjeometria;
- përpunimi i shënimeve dhe probabilitetit;

Konceptet e përgjithshme janë të zërthyera në tema dhe për secilën temë janë paraqitur rezultatet e të nxënimit që bazën mbështetëse e sigurojnë nga rezultatet e të nxënimit për shkallë.

Nëpërmes situatave të thjeshta jetësore dhe lojërave të ndryshme nxënësi natyrshëm mëson konceptet për numërimin, numrat deri në 100, krahasimin e sasive, matjet, kohën dhe modelimin, konceptet për figurat, trupat gjeometrikë, orientimin, vendndodhjen e objekteve në hapësirë për mënyrën e grumbullimit të e të dhënave dhe për konceptin e ndodhjes së një ngjarje.

KONCEPTI	TEMAT	REZULTATET E TË NXËNIT PËR TEMËN
Numri, algoritmet dhe algjebra	Numrat natyrorë	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Lexon dhe shkruan numrat natyrorë deri në 1000 dhe përcakton vlerën e çdo shifre. ▪ Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave natyrorë deri në 1000. ▪ Kryen shumëzimin e numrave njëshifrorë me numra njëshifrorë dhe dyshifrorë ▪ Njehson herësin ndërmjet numrave dyshifrorë dhe treshifrorë me numra njëshifrorë ▪ Identifikon qindëshet dhe dhjetëshet e mijëshes së parë ▪ Tregon paraardhësin, pasardhësin e numrave deri në 1000 si dhe krahason ata numra. ▪ Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes, zbritjes, shumëzimit dhe pjesëtimit të numrave; ▪ Përdor vetinë komutative dhe asociative për gjetjen e shumës, ndryshimit, prodhimit dhe herësit të numrave. ▪ Zbaton varshmërinë e shumës nga mbledhorët dhe pandryshueshmërinë e shumës; ▪ Zbaton varshmërinë e ndryshimit nga i zbritshmi, zbritësi dhe pandryshueshmërinë e ndryshimit; ▪ Analizon varshmërinë e prodhimit nga faktorët; ▪ Analizon varshmërinë e herësit nga i pjesëtueshmi dhe pjesëtuesi; ▪ Zbaton shumëzimin dhe pjesëtimin në probleme; ▪ Zbaton mbledhjen dhe zbritjen në problema; ▪ Tregon si rriten kufizat ne varg apo vargje numerike; ▪ Përcakton vlerën e shprehjeve numerike; ▪ Njehson vlerën e shprehjes duke u bazuar në radhën e veprimeve aritmetike në shprehjet numerike; ▪ Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura; ▪ Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave ; ▪ Mbledh dhe zbret paratë (euro); ▪ Vendos shkronjat në vend të numrave ; ▪ Paraqet pikat në rrjetin koordinativ; ▪ Shënon koordinatat e pikave të dhëna në rrjetin koordinativ.

Numrat thyesë	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Paraqet si numra thyesorë paraqitjet grafike të thyesave ▪ Dallon thyesat që tregojnë të njëjtën pjesë të një tërësie ▪ Cakton pjesën e një tërësie ▪ Krahason thyesat me emërues/numërues të njëjtë ▪ Mbledh dhe zbret thyesat me emërues të njëjtë
Modelt	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Zbaton formula të thjeshta për të plotësuar vargjet numerike dhe prezanton hapat deri te arritja e zgjidhjes; ▪ Zbulon rregullën dhe shkruan kufizat e vargut numerik; ▪ Praktikon modelet e dhëna në jetën e përditshme.
Bashkësitë dhe relacionet	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përshkruan bashkësinë si një grumbull elementesh duke dhënë shembuj nga jeta e përditshme; ▪ Identifikon elementet që i takojnë/nuk i takojnë bashkësisë; ▪ Krahason bashkësitë sipas numrit të elementeve; ▪ Klasifikon objektet sipas veçorive të tyre; ▪ Krijon nënbashkësi nga bashkësitë e dhëna; ▪ Gjen elementet e përbashkëta të dy bashkësive (prerjen); ▪ Paraqet bashkësinë me kllapa gjarpërore dhe përmes diagramit të Venit; ▪ Jep shembuj për bashkësitë nga jeta e përditshme; ▪ Zbaton në praktikë barazinë dhe jo barazinë e bashkësive; ▪ Krijon relacione ndërmjet dy bashkësive të dhëna; ▪ Paraqet shembuj praktik nga jeta lidhur me relacionet.
Shprehjet shkronjore	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kryen veprimet me shprehje shkronjore; ▪ Gjen vlerën (numerike) të shprehjes shkronjore për vlera të caktuara të ndryshoreve; ▪ Shndërron shprehjet me fjalë në shprehje me simbole dhe anasjelltas; ▪ Zgjidh problema nga jeta e përditshme duke përdorur shprehjet shkronjore.
Ekuacionet dhe inekuacio.	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Identifikon në shprehje të panjohurën dhe e gjen atë; ▪ Gjen bashkësinë e zgjidhjeve për inekuacionin e dhënë; ▪ Zgjidh problema me fjalë nga jeta e përditshme duke përdorur ekuacionet dhe inekuacionet.

Matjet	Njësitë matëse	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kryen matje të ndryshme duke përdorur njësitë standarde; ▪ Përdor metrin (m) dhe nënfishat e metrit si dhe kilometrin si njësi matëse të gjatësisë dhe kryen veprime me këto njësi; ▪ Përdor tonelatën (t), kilogramin (kg),dekagramin (dg) dhe grammin (g) si njësi matëse të peshës dhe kryen veprime me këto njësi; ▪ Përdor litrin (l) dhe nënfishat e litrit si njësi për matjen e lëngjeve dhe kryen veprime me këto njësi; ▪ Krahason objekte të ndryshme bazuar në matjet e bëra; ▪ Përcakton njësitë për matjen e kohës (dita , ora , minuta dhe sekonda); ▪ Zgjidh problema me fjalë në lidhje me gjatësinë, peshën dhe kohën; ▪ Krahason vëllimin e trupave bazuar në vëzhgimet që bën
	Sipërfaqja	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Ngjyros sipërfaqet e brendshme të figurave të ndryshme ▪ Bën dallimin në mes të sipërfaqes së brendshme dhe të jashtme të figurës ▪ Gjen syprinën e sipërfaqes së katrorit dhe drejtkëndëshit
Hapësira dhe forma	Orientimi	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përcakton pozitën e objekteve ▪ Zgjidh detyra të ndryshme problemore lidhur me orientimin
	Figurat gjeometrikë	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Emërton figurat gjeometrike, si: trekëndëshi,drejtkëndëshi, katrori, rrethi etj.; ▪ Përkufizon shumëkëndëshin dhe tregon llojet e tij; ▪ Përcakton brinjët, kulmet dhe këndet e figurave gjeometrike; ▪ Vizaton trekëndëshin, drejtkëndëshin, katrorin dhe rrethin; ▪ Dallon drejtëzën , gjysmëdrejtëzën dhe segmentin dhe i përkufizon ato; ▪ Krahason segmentet e ndryshme; ▪ Cakton pozitën e dy drejtëzave - drejtëza paralele dhe drejtëza normale; ▪ Ngjyros figurën simetrike dhe krijon figura simetrike; ▪ Jep shembuj praktik lidhur me përdorimin e figurave gjeometrike në jetën e përditshme;

		<ul style="list-style-type: none"> ▪ Njehson perimetrin e figurave gjeometrike (trekëndëshit , katërkëndëshit, katrorit); ▪ Zbulon formula të thjeshta për gjetjen më të lehtë të perimetrit të figurave.
	Trupat gjeometrikë	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Emërton trupat gjeometrikë (kubi, kuboidi, sfera, cilindri, koni , piramida); ▪ Krahason trupat gjeometrikë (përmasat e tyre); ▪ Gjen vëllimin e trupave të rregullt dhe të parregullt gjeometrikë duke përdorur formula të thjeshta apo enë të ndryshme; ▪ Përcakton faqet, brinjët dhe kulmet e trupave gjeometrikë; ▪ Identifikon objekte natyrore të ngjashme me kubin; kuboidin, sferën, cilindrin , konin , piramidën; ▪ Bën dallimin ndërmjet figurave gjeometrike dhe trupave gjeometrikë.
Funksionet dhe ndryshoret	Ekuacionet lineare me një të panjohur	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Zbulon të panjohurën në detyrat e dhëna; ▪ Paraqet zgjidhjen e problemave përmes skemave të ndryshme; ▪ Gjen zgjidhjen e barazimeve të dhëna.
	Inekuacionet lineare me një të panjohur	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Zgjidh problema të thjeshta me fjalë; ▪ Gjen bashkësinë e zgjidhjeve të inekuacioneve (numra deri në 1000); ▪ Përdor algoritmet për zgjidhjen e problemave.
Të dhënat dhe probabiliteti	Të dhënat	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Grumbullon dhe sistemon të dhënat në tabelat përkatëse; ▪ Lexon të dhënat e grumbulluara; ▪ Paraqet të dhënat me tabelë dhe me diagram; ▪ Komenton të dhënat e paraqitura në tabelë apo diagram, si dhe i krahason ato; ▪ Përdor piktogramet .
	Probabiliteti	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Parashikon mundësinë (me dallime mesatare); ▪ Bën provën, e mundur, e pamundur.

Udhëzime metodologjike

Metodologjitë e mësimdhënies së matematikës në klasën tretë, bazohen në parimet e mësimdhënies të përcaktuara në Kornizën Kurrikulare e cila synon një mësimdhënie që siguron kompetencat në të nxënë. Temat që paraqiten në programin e klasës së tretë nuk mund të zhvillohen të shkëputura dhe të ndara, por ato janë të lidhura me fusha të tjera. Rezultatet e të nxënit për secilën temë shërbejnë dhe për kërkesat dhe nocionet që synojnë edhe temat të tjera brenda fushës. Formimi matematik është një proces kompleks që kërkon një gërshetim të harmonishëm midis rezultateve të të nxënit dhe një mësimdhënieje të kujdesshme që i vendos ato në funksion të njëra-tjetrës.

Mësimdhënësi përqendrohet kryesisht në këto aspekte:

- lidhja e rezultateve të të nxënit të kompetencave kryesore me rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës dhe rezultateve të temave;
- mësimdhënia dhe të nxënit bazuar në kompetenca;
- mësimdhënia me nxënësin në qendër;
- mësimdhënia dhe të nxënit e integruar;
- zhvillimi i temave ndërkurrikulare.
- zhvillimi i veprimtarive me arsimim të qëndrueshëm.

Mësimdhënësit i sugjerohet ta ndërtojë punën mbi:

- përcaktimin e temës për ta zhvilluar;
- zbatimin e metodave, teknikave dhe strategjive të cilat bazohen në ndërveprim;
- mundësinë në qasje në të gjitha mjetet më të domosdoshme që u nevojiten nxënësve;
- motivimin, nxitjen dhe lavdërimin e përhershëm të nxënësve;
- informimin dhe mbajtjen në lidhje të vazhdueshme me prindërit për progresin e nxënësve të tyre.

Themeli i marrëdhënieve mësimdhënës – nxënës është ndërveprimi ku mjedisi, bashkëpunimi nxënës - nxënës, përdorimi i mjeteve dhe materialeve stimulon gjithmonë një pjesëmarrje aktive të nxënësve në të nxënë. Të nxënit përmes lojës dhe ushtrimet në grupe dhe individuale, konsiderohen prioritete në formimin matematik, e sidomos në zgjidhjen e problemeve dhe të menduarit konstruktiv.

Mësimi i matematikës në klasën e tretë duhet të bëhet me metoda të avancuara dhe me forma moderne të punës me një qasje njohëse që përfshin zhvillimin konceptuar, njohuritë dhe miratimin e skemave kuptimplote. Përmbajtja e matematikës duhet të jetë e lidhur tematikisht e të mësuarit me lëndë të tjera.

Nxënësit duhet të trajnohen për punë të pavarur, punë në çifte, grupe të vogla dhe të mëdha, nga se kjo jep mundësi për të treguar guxim në zbulimin dhe eksplorimin e ri e të panjohur, të respektojnë rregullat, vlerat, qëndrimet personale dhe të të tjerëve, për të zhvilluar aftësitë e komunikimit dhe puna ekipore.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Matematika u shërben të gjitha fushave, me koncepte dhe me aftësi. Lidhja e matematikës me fushat e tjera pasuron situatat e të nxënit, në të cilat nxënësi zhvillon kompetencat e tij. Nga ana tjetër edhe përmbajtja e matematikës (si: numrat, raportet, figurat, kuptimi për hapësirën, përpunimi i të dhënave etj.) mund të përdoren në studimin e fushave të tjera. Matematika është një mjet ndihmës i domosdoshëm për shkencat e natyrës, por njëkohësisht luan një rol të rëndësishëm në të gjitha fushat e tjera. Ndërkohë, matematika përdor konceptet e shkencave të tjera për të qartësuar, lehtësuar, konkretizuar konceptet matematike dhe për të formuar te nxënësit bindjen rreth dobisë së matematikës në funksionimin e botës reale. Fushat e tjera ndihmojnë nxënësin të kuptojë evolucionin matematikor. Duhet theksuar se studimi i gjuhëve e ndihmon nxënësin të zhvillojë dhe përdor konceptet matematikore.

Matematika ka një shumëllojshmëri të aplikimeve në jetën e përditshme dhe është e lidhur ngushtë me shumë komponentë të arsimit, e që njëkohësisht kontribuon në realizimin e këtyre temave: ngrohja globale, burime të përhershme e te pashtershme, njohja e kulturave, zhvillimi i qëndrueshëm, bashkëjetesa paqësore, planifikimi i buxhetit etj., nxënësi duhet të zgjidhë situata dhe probleme, duhet të përdor arsyetimin matematik dhe elemente të gjuhës matematikore, në mënyrë që të qartësojë dhe të shpjegojë çështje të ndryshme që lidhen me realizimin e tyre. Përmes situatave të paraqitura në temat ndërkurrikulare, nxënësi ka mundësi të bëjë lidhjet ndërmjet kompetencave matematikore me shembuj të caktuar për realizimin e këtyre temave.

Nxënësi mëson të realizojë disa etapa, kur zgjidh një problem apo situatë dhe kjo aftësi kontribuon në rritjen e tij personale duke i ndihmuar ata të gjejnë vendin e tyre në shoqëri. Nxënësi mund të përdor metodat statistikore si anketa, intervista për të bërë analiza rreth mendimit të njerëzve, mund të arsyetojë dhe argumentojë një vendim të caktuar. Kështu, ai mëson të marrë pjesë në jetën shoqërore në klasë dhe në shkollë, zhvillon një qëndrim të hapur ndaj botës duke respektuar diversitetin.

Nxënësi inkurajohet të zhvillojë marrëdhënie aktive në mjedisin duke ruajtur një qëndrim kritik ndaj mallrave të konsumit. Duke përdorur të kuptuarit për numrat, arsyetimin e raporteve, interpretimin e përqindjeve, nxënësi mund të ushtrojë gjykimin e tij kreativ dhe kritik për konsumimin dhe përdorimin e mallrave të konsumit. Njohuritë statistikore dhe probabiliteti mund të ndihmojnë nxënësin të interpretojë të dhëna për promovimin e shëndetit të mirë, traditës e zakoneve të jetesës dhe për të ushtruar gjykimin, argumentimin për vendimet e marra.

Nxënësi përdor aftësitë e tij matematikore që kanë të bëjnë me simbole, vizatime, grafikë për të zhvilluar marrëdhënie aktive në mjedisin e tij. Ai mund të shpjegojë fenomenet në botën e tyre dhe ndërvarësitë e mjedisit dhe botës njerëzore.

Udhëzime për vlerësim

Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënët bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies i cili përqendrohet në nivelin e arritjes së kompetencave. Vlerësimi i përmbajtjes lidhet me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive matematikore nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e nxënësve. Gjatë vlerësimit mësimdhënësi, duhet të ketë parasysh rezultat e të nxënët për tema mësimore të klasës, duke i pasur parasysh rezultatet e shkallës.

Vlerësimi i arritjes së nxënësve në klasën tretë në matematikë realizohet nëpërmjet: evidencës së vlerësimit të vazhdueshëm, vëzhgimi në klasë, vlerësimi përmes portofolios, testeve të shkurtra, paraqitjes me gojë dhe forma të tjera, ndërsa raportimi i të arriturave të nxënësve bëhet përmes përshkrimeve me komenteve konstruktive.

Vlerësimi duhet të përqendrohet në **kontrollin** e zhvillimit të koncepteve për atë se sa nxënësi: numëron në mënyrë korrekte objektet nga 1 deri në 100, kryen veprimin e mbledhjes dhe zbritjes së numrave deri 100, interpreton tabelën e shumëzimit deri me pesë dhe përvetëson si të plotë deri me dhjetë, tenton kryej veprimin e presimit si veprim i kurdët me shumëzimin e numrave deri 1000, njih format (katror, trekëndësh, rreth), dhe trupat me qoshe dhe të rrumbullak, klasifikon sendet sipas ngjyrës, formës dhe masës, vendos në grup gjërat që janë njëloj, rendit objektet sipas rregullit të masës, përdor fjalë si: "më i madh" dhe "më i vogël" që të bëjë krahasimin, krahason masën e grupeve të lodrave ose të sendeve.

Kryesisht vlerësohet:

- puna që nxënësi bënë në klasë
- realizimi i detyrave në shtëpi
- portfolio si një tregues i aktivitetit në të mësuarit dhe miratimin e përmbajtjes matematikore.

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Gjatë mësimit të matematikës mësimdhënësi i ofron nxënësit informatat e domosdoshme dhe **performon** shkathtësi duke përdorur materiale didaktike dhe burime të nevojshme, ndërsa nxënësi **gjeneron** informacione, **formon** dhe **zhvillon** shkathtësi duke iu qasur të mësuarit përmes shikimit, të dëgjuarit, të prekjes dhe formave të tjera.

Për arritjen e kompetencave të nivelit të tretë të arsimit fillor për klasën e tretë, mësimdhënësi siguron qasje përmes përdorimit të materialeve të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit.

Mësimdhënësi, përveç materialeve dhe mjeteve të nevojshme didaktike, bën vizatime dhe modelime matematike, jep ndihmë të veçantë, përshtat shembuj të llojeve të ndryshme, krijon

mjedis dhe klimë për aktivitete alternative. Ai po ashtu iu ofron edhe mjete teknike dhe teknologjike për të zhvilluar aftësitë e tij në mësimin e matematikës si: *pamore natyrore, artificial, audioviziv, dëgjimore, verbale, tekstet etj.*

Materialet që mund të përdoren për tema nga matematika: material të riciklueshme; petëza; tabela magnetike; grafikë të numrave; kuti me forma të ndryshme; figura gjeometrike me forma dhe ngjyra të ndryshme; fije shkrepëse; shkopinj didaktikë; fleta me dhe pa ngjyra; lapsa; numëratore me gogla; lapsa me ngjyra, tabela për regjistrimin e të dhënave; vargje me gogla; fletëpalosje për të lidhur numrin me sasinë; lodra të ndryshme; kuba; trupa gjeometrik. Shumë me rëndësi është edhe shfrytëzimi i internetit me materiale për temat që i zhvillon.

**FUSHA KURRIKULARE: SHKENCAT E
NATYRËS**

**Kurrikula lëndore/programi mësimor
Njeriu dhe natyra**

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Njeriu dhe natyra

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Fusha, Shkencat e natyrës për klasën e tretë, në shkallën e dytë përmban përforsimin dhe zhvillimin e konceptëve natyrore të cilat spjegohen në kuadër të lëndëve të integruara mbrenda fushës. Nxënësit po ashtu rrisin shkathtësitë, krijojnë shprehitë, dhe vleratë e tyre përkitazi me këto dukuri. Lënda, Njeriu dhe natyra inkurajon nxënësit të kuptojnë botën që i rrethon dhe të analizojnë shkaktarët, pasojat, ndërveprimet si dhe të njohë mjedisin si tërësi.

Detyrë e mësimit të lëndës Njeriu dhe natyra, është zhvillimi i shprehive të hulumtimit, i të menduarit kritik, kreativitetit, nxitjes së pikëpamjeve të hapura dhe i motivimit të nxënësve të klasës së tretë për të mesuar.

Qëllimi

Qëllimi i të mësuarit të lëndës Njeriu dhe natyra është:

- Zhvillimi i njohurive dhe të kuptuarit e koncepteve shkencore dhe teknologjike përmes hulumtimit të proceseve biologjike, fizike, kimike dhe gjeografike në mjedis.
- Zhvillimi i qasjes shkencore që ndihmon të kuptuarit dhe të menduarit kritik e krijues.
- Inkurajimi i fëmijëve të njohin, të hulumtojnë, të zhvillojnë dhe zbatojnë idetë dhe konceptet shkencore përmes lojërave, vizatimeve dhe aktiviteteve praktike.
- Nxitja e fëmijëve për të vlerësuar kontributin e shkencës dhe teknologjisë në jetën e përditshme.
- Kultivimi i kujdesit dhe respektit për diversitetin e botës së gjallë, mjedisit fizik dhe varësinë e bashkëveprimit në mes tyre
- Frymëzimi i nxënësve për ngritjen e përgjegjësisë për të mbrojtur, përmirësuar dhe dashur mjedisin duke u involvuar në identifikimin, diskutimet dhe aktivitetet për problemet mjedisore që të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm.
- Gatishmëria e nxënësve për të komunikuar në mes veti idetë dhe të gjeturat nga vëzhgimet dhe vizitat në natyrë dhe analizimi.

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Temat e lëndës Njeriu dhe natyra për klasën e tretë janë të bazuara në konceptet e fushës, ndërsa rezultatet e të nxënit lëndë (RNL) i përmbushin ato duke marrë në konsideratë moshën dhe nivelin e nxënësve të klasës së tretë. Gjithashtu temat, bashkë me rezultatet e të nxënit kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave e të cilat janë të paraqitura në Kurrikulën bërthamë të këtij niveli.

Mësimdhënësi gjatë aktiviteteve në klasë, shkollë, natyrë etj. duhet të nxisë nxënësit, të njohin, vrojtojnë, radhisin, masin, shënojnë, mbledhin të dhëna, provojnë, mendojnë në mënyrë të pavarur si dhe të japin mendimet e tyre.

Në lëndën e Njeriu dhe natyra për klasën e tretë përvetësohen dhe zhvillohen, kryesisht këto koncepte natyrore:

- Materia, vetitë dhe shëndrrimet;
- Bota e gjallë;
- Proceset fizike;
- Toka, mjedisi dhe gjithësia.

Koncepti	RNF:	
	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNLT)
Materia, vetitë dhe shndërrimet	1. Vrojton, përshkruan dhe krahason materialet, sipas origjinës, përbërjes, vetive, madhësisë, formës, shndërrimeve dhe përdorimit në jetën e përditshme.	<ul style="list-style-type: none"> • Tregon për nocionet matëryale, lëndet e para, lëndë e pastra dhe lëndë të përziara, • Dallon lëndët në bazë të gjendjeve agregate, në bazë origjinës dhe nga përbërja, • Përshkruan tri gjendjet agregate të ujit, • Kupton gjendjet agragate të ujit, • Kupton gjendjen e gaztë të ujit përmes ciklit në natyrë, • Përmend rolin e ujit të pijshëm për organizmin e njeriut, • Përshkruan matjën e temperatures me thermometer, • Tregon për përbërsit kryesor të ajrit dhe për rolin e oksigjenit në frymëmarrje.
Bota e gjallë	RNF: <ol style="list-style-type: none"> 1. Përshkruan rëndësinë e përdorimit të llojlojshmërisë dhe sasisë së ushqimit të shëndetshëm, si dhe kujdeset për higjienën personale. 2. Vrojton dhe përshkruan karakteristikat themelore dhe nevojat jetësore të njeriut dhe qenieve të tjera të gjalla, llojlojshmërinë biologjike, ndërveprimin e organizmave me mjedisin natyror si dhe rritjen dhe zhvillimin e tyre në mjedisin natyror. 	
		<ul style="list-style-type: none"> • Kupton dhe interpreton rolin e ushqimit si burim energjie për funksionet jetësore të njeriut si dhe rolin e ushqimit për jetën e shëndetshme, • Identifikon dhe përshkruan përbërsit kryesor të ushqimit

	<p>Nevojat jetësore të njeriut, ushqimi dhe higjena personale</p>	<p>të njeriut (nutrientëve): ujin, sheqernat, yndyrnat, proteinat, mineralet, vitaminat përfshirë rolin e secilit nga to për organizmin,</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dallon dhe liston produktet ushqimore me bazë bimore dhe shtazore që përdor në jetën e përditshme përfshirë ushqimet me shenjat bio dhe eko, • Hulumton dhe dallon produktet ushqimore të shëndetshme dhe ato jo të shëndetshme për moshën specifike, • Ndërton piramidën e thjeshtë të ushqimit të njeriut sipas vlerave ushqimore dhe për shëndetin, • Shpjegon rolin e ushqimeve të shëndetshme dhe higjenike për një jetë të shëndetshme, • Aplikon në jetë udhëzimet për ruajtjen e ushqimeve nga mikrobet dhe ndotja, njeh afatet e përdorimit në etiketa dhe kushtet e higjenës së tyre për përdorim, • Shpjegon dhe liston produktet higjenike që përdoren në jetën e përditshme.
--	--	---

	<p>Ndërveprimet e organizmave të gjallë</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Hulumton ndërveprimin mes organizmave të gjallë dhe mjedisit jetësor, por edhe ndërveprimet e organizmave të gjallë në mes veti në mjedisin ku jetojnë, • Njeh dhe përshkruan konceptet e aksionit, reaksionit dhe koaksionit në ndërveprimet e organizmave të gjallë me mjedisin jetësor dhe me njeri-tjetrin, • Definin përbërsit e piramidës ushqimore në ekosistemet e gjalla sipas rolit të tyre: prodhues, konsumues dhe zbërthyes dhe lidhjen e tyre në zinxhirët ushqimor, • Shpjegon dhe interpreton nevojat e organizmave bimor për jetë siq janë: uji, drita, dheu, materiet minerale dhe gazet: dioksid karboni dhe oksigjeni, • Shpjegon dhe interpreton nevojat e organizmave shtazor për jetë: nevojat për ushqim me bazë bimore dhe shtazore, ujë, strehim, riprodhim etj.; • Ndërton piramidat ushqimore në ekosistem dhe klasifikon organizmat që njeh sipas këtyre kategorive ekologjike përfshirë njeriun si pjesë e tyre.
	<p>Edukimi Seksual</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Definin konceptin e familjes dhe strukturat e ndryshme (me dy prind, me një prind...), • Përshkruan nevojat dhe rolet e anëtareve brenda familjes, • Shpreh emocionet, dëshirat dhe nevojat e saj/tij, • Dallon relacionet e ndryshme në raport me miqësinë dhe dashurinë në familje dhe në shoqëri.
<p>Proceset fizike</p>	<p>RNF:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dallon gjendjen e qetësisë nga gjendja e lëvizjes së trupave, përshkruan lloje të ndryshme të lëvizjeve duke i vendos në lidhshmëri me veprimin e forcave. 2. Identifikon burimet e ndryshme të energjisë (duke përfshirë rolin e nxehtësisë së Diellit për jetën në Tokë) për shfrytëzimin efikas të tyre për jetën e njeriut. 	

	Fërkimi dhe shtypja	<ul style="list-style-type: none"> • dallon sipërfaqet e lëmuara nga sipërfaqet e vrazhda të trupave dhe gjen shembuj për varshmërinë e fërkimit nga lloji i materialit të sipërfaqeve takuese, • ven në dukje shembuj të zmadhimit të temperaturës me fërkim të sipërfaqeve takuese, • demonstroi dallimin e fërkimit të qetësisë, të lëvizjes dhe të rrokullisjes me ndihmën e kanaqes së mbushur me një pije freskuese, • demonstroi shembuj të fërkimit të vogël apo të madh dhe të zvogëlimit apo të zmadhimit të tij, • tregon vetitë të dëmshme dhe të dobishme të fërkimit në jetën e përditshme, • paraqet shembuj të shtypjes së trupit në jetën e përditshme me ndihmën e peshës dhe sipërfaqes së vendosjes së tij, • demonstroi vartësinë e shtypjes që bën i njëjti trup kur vendoset në sipërfaqe me vlera të ndryshme dhe kur trupat e ndryshëm vendosen në sipërfaqe me vlera të njëjta dhe nxjerr përfundime, • gjen shembuj tjerë për vërtetimin e varsh mërisë së shtypjes nga pesha e trupit dhe sipërfaqes së vendosjes së tij.
	Bashkë- veprimi i trupave	<ul style="list-style-type: none"> • dallon me shembuj lloje të bashkëveprimit të trupave në natyrë që takohen, • tregon se Dielli, Toka dhe Hëna janë trupa qiellor, qëndrojnë pezull në hapësirë dhe tërhiqen mes veti (bashkëveprojnë) në largësi, pa u takuar fare, • gjen shembuj të ngjashëm me rendjen e mollës, dardhës apo ftonit nga pema si bashkëveprim të trupave pa u takuar, • dallon forma të magneteve, demonstroi tërheqjen e limaturës së hekurit me ta dhe gjen metale që nuk tërhiqen me magnetet, • demonstroi dëbimin dhe tërheqjen e poleve të njëjta apo të kundërta të magneteve si bashkëveprim të trupave pa u takuar.

	Llozi dhe rrafshi i pjerrët si makina të thjeshta	<ul style="list-style-type: none"> • shpjegon me fjalë dhe me vizatim llozin dy krahësh (qyskia), pozitën e barrës Q, pozitën e veprimit të forcës F(duart) dhe krihet e tyre ndaj pikës mbështetëse O, • demonstroi ngritjen sa më të lehtë të barrës me lloz duke zmadhuar krahun e veprimit të forcës F (duart) ndaj krahut të barrës Q nga pika mbështetëse O, • demonstroi punën me gërshërë dhe me darë dhe identifikon në to krahun e barrës, pikën mbështetëse dhe krahun e veprimit të forcës (duarve), • demonstroi tërheqjen e trupit të lidhur nëpër rrafsh të pjerrët dhe hulumton vartësinë e tërheqjes më të lehtë nga lartësia e tij.(dërrasë e vendosur në disa libra, spango, tullë, dinamometër), • demonstroi baraspeshimin mes dy trupave të vendosur në krahët e kundërt të llozit dy krahësh ndaj pikës mbështetëse të tij.
Toka, mjedisi dhe gjithësia	RNF: <ol style="list-style-type: none"> 1. Identifikon mënyrat e orientimit dhe lëvizjet në hapësirë, dhe tregon forma të thjeshta të bashkëveprimit në relacionin njeri-naturë, dallon disa nga llojet e ndotjes së mjedisit që shkaktohen nga faktorë të ndryshëm në rrethin ku jeton e më gjerë, tregon për rolin që ka në ruajtjen e mjedisit dhe ndërmerr veprime të dobishme që promovojnë mjedisin e pastër. 2. Përshkruan veçorit e elementeve natyrore të mjedisit natyror (relievin, klimën, ujërat, botën bimore dhe shtazore). 	
	Vendi dhe hapësira	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan Tokën, Diellin, Hënën dhe planetët si trupa të sistemit diellor, • Tregon planetët që përbëjnë sistemin tonë diellor dhe identifikon planetin më të madh dhe më të vogël, më të afërt dhe më të largët me Diellin si dhe objektet që shohin natën në qiell (Hënën, yjet), • Kupton se objektet, pjesët e sipërfaqes dhe Toka mund të paraqiten në letër, në glob, të zvogëluara dhe me shenja të veçanta si dhe përse shërben hartimi i planetit të një vendi ose ndërtese.

Sistemet fizike	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan, identifikon, dallon dhe krahason elementet natyrore në mjedisin ku jeton; format kryesore të relievit (malet, fushat, lumenjtë, liqenet etj.) në mjedisin ku jeton; udhëtimin nga shtëpia në shkollë, ose nga vendi i banimit në piknik dhe anasjelltas; motin (me diell, shi, erë, etj.
Bashkëveprimi njeri-natyrë	<ul style="list-style-type: none"> • Tregon për mënyrat e ndikimit të njeriut në natyrë (si të ruhet cilësia e ajrit, ujit dhe tokës) dhe rëndësinë e ruajtjes së mjedisit (me figura, me shenja të informimit etj.).

Udhëzime metodologjike

Për të arritur sa më lehtë realizimin e përmbajtjes së lëndës njeriu dhe natyra mësimdhënësi përzgjedh metodologjitë më adekuate, si dhe brenda saj përdor teknika dhe forma të ndryshme duke i përshtatur moshës, nevojave dhe mundësive të nxënësve.

Në bazë të përmbajtjes së temave mësimdhënësi përdor mjete, materiale dhe prova të ndryshme me qëllim të realizimit të aktiviteteve në mënyrë praktike në formë të aktiviteteve dhe lojrave. Lënda, Njeriu dhe natyra kërkon nga mësimdhënësi një qasje menaxhuese duke përdorur forma ndërvepruese, gjithëpërfshirëse, ekipore dhe krijuese gjatë mësimdhënies dhe mësim nxënies. Mësimdhënia dhe mësimnxënia cilësore kërkon qasje metodologjike si më poshtë:

- Mësimdhënie dhe nxënie me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirje,
- Mësimdhënie dhe nxënie të bazuar në qasjen e integruar,
- Mësimdhënie dhe nxënie të bazuar në arritjen e kompetencave,
- Mësimdhënie dhe nxënie të diferencuar,

Në të gjitha rastet zbatimi i metodologjisë kërkon përdorimin e teknikave, materialeve dhe mjeteve didaktike pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritura për këtë klasë e tretë, duke realizuara praktikatat me të mira mësimore.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare që mund të integrohen në Kurrikulën e shkencave të natyrës për këtë moshë të nxënësve janë:

- **Edukimi për media;**
- **Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm**

Edukimi për media

I referohet njohjes së llojeve të mediave që shpërndajnë e informacione të reja dhe të sakta, për hulumtimet dhe zbulimet e reja shkencore. Çështja e edukimit për media përfshin përmbajtjet lidhur publikimet, shpërblimet për të arriturat në shkencë në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Arsimimi për zhvillim të qëndrueshëm

I referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në formësimin e nxënësve për një qëndrim të ndërgjegjshëm ndaj çështjeve në vetëdijesimin dhe ruajtjen e pasurive natyrore, në nivel shkolle dhe mjedisit ku jeton. Këtu hyjnë çështjet si : aspekti social, ekonomia familjare, riciklimi etj.

Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm përfshijnë aspektet për të pasur mjedis të shëndetshëm që ndërlidhet me vetëdijesimin dhe rëndësinë e shfrytëzimit të burimeve mjedisore si trashëgimi e brezit të ardhshëm.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është proces i grumbullimit sistematik, cilësor e sasior të informatave të arritjes së nxënësve gjatë procesit të të nxënësve dhe nxjerrja e gjykimeve për to.

Mësimdhënësi vlerëson në mënyrë sistematike punën dhe aktivitetet e nxënësve. Vlerësimi, mundëson marrjen e informacioneve kthyesë për të arriturat e nxënësve si dhe vështirësitë që i hasin ata. Gjatë vlerësimit duhet të maten shkathhtësitë, vlerat dhe qëndrimet në lëndën njeriu dhe natyra.

Krahas vlerësimit të arritjes së rezultateve nga nxënësit e që mund të maten përmes testeve, kuizeve, portfolio-s, detyrave të shtëpisë etj të rëndësishme janë edhe vlerësimet për angazhimet konstruktive në punë praktike dhe në ndjekjen e ecures së detyrës së hulumtimit.

Ky vlerësim për lëndën Njeriu dhe natyra mund të bëhet në forma të ndryshme, duke përdorur instrumente të ndryshëm të standardizuara, të specifikuara me kritere të hartuara nga mësimdhënësi, në harmoni me politikat arsimore.

Vlerësimi i mbrendshëm i nxënësve bëhet sipas UA-së për vlerësim. Nxënësit e shkallës II (klases 3) vlerësohen vetëm më vlerësimin përmbledhës 1 (VP1 dhe VP2), me notë numerike dhe komente të standardizuara kundrejt rezultateve të të nxënësve.

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Për shkak të specifikave që ka lënda Njeriu dhe natyra, është e domosdoshme të përdoren materialet dhe burimet e shumta mësimore, me qëllim të arritjes së rezultateve të nxënësve sa më të mirë. Është shumë e nevojshme krijimi i kushteve, sigurimi i mjeteve mësimore si dhe mjedisi i përshtatshëm për realizimin me sukses të koncepteve të fushës. Realizimi i mësimin në laborator, punëtori, natyrë, ferma etj krijon kushte solide dhe ndihmon nxënësit për nxënie më të lehtë dhe shumë konkrete.

**FUSHA KURRIKULARE: SHOQËRIA DHE
MJEDISI**

**Kurrikula lëndore/programi mësimor
Shoqëria dhe Mjedisi**

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Shoqëria dhe Mjedi

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Lënda Shoqëria dhe Mjedisi, në klasën e tretë, i krijon nxënësit mundësi të zhvillon kompetencat kryesore të synuara me dokumentet kurrikulare të Kosovës. Përmes mësimit të kësaj lënde i mundësohet nxënësit të kultivon identitetin e tij personal. Kjo lëndë i mundëson atij që të marr njohuri për shoqërinë, kulturën, të mësuarit për të jetuar bashkë me të tjerët, edukimin mjedisor si dhe edukimin për zhvillim të qëndrueshëm.

Përmes temave të kësaj lënde, nxënësi ,do të kuptojë më mirë konceptin e kohës, ndryshimet në shoqëri dhe natyrë; të analizojë dhe të zbatojë në praktikë idetë e tij , detyrat dhe përgjegjësitë që i takojnë, bashkëveprimin dhe rëndësinë e marrjes së vendimeve të duhura, si dhe të jep kontributin në mjedisin e tij shoqëror.

Qëllimi

Qëllimi i programit të lëndës Shoqëria dhe Mjedisi, ka të bëjë me ndërtimin dhe zhvillimin e njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave që kërkon shoqëria demokratike. Që nxënësi të aftësohet për të vepruar në mënyrë të pavarur, të bëhet bashkëpunues, të kontribuojë në ndërtimin e mirëqenies vetanake dhe të shoqërisë.

Temat mësimore të parapara me program dhe metodologjia e mësimdhënies, i mundëson nxënësit të zhvilloj të menduarit kritikë e krijues, dhe të jetë i gatshëm për përballje aktive në situata të ndryshme jetësore; të zhvilloj aftësinë për të komunikuar me të tjerët dhe për të mësuar nga përvojat e ndryshme; aftësinë për të identifikuar dhe kuptuar problemet dhe për të vlerësuar vendimet e marrura.

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Nxënësi në klasën e tretë duhet t'i arrijë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Shoqëria dhe Mjedisi, të shkallës së dytë (Shk2) të Kurrikulës Bërthamë të Klasës Përgatitore dhe Arsimit Fillor.

Koncepti	RNF, Tema dhe RNL	
Individi, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore	<p>RNF: 1. Mëson për vetveten, strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e përfshirjes në to</p> <p>1.1. Identifikon dhe krahason dëshmi të thjeshta (objekte, mjete, fotografi, veshje dhe gjëra të tjera) që lidhen me ngjarje personale, familjare dhe të komunitetit ku jeton dhe i klasifikon sipas kronologjisë.</p> <p>1.2. Dallon strukturën e grupeve të ndryshme shoqërore si p.sh.: familja, shkolla, etj., dhe mund të bëjë krahasime si kanë qenë ato dikur dhe si janë tani.</p> <p>1.3. Kupton dhe respekton të drejtat e njeriut dhe të drejtat themelore të fëmijëve si mënyra më e mirë për mbrojtjen e individëve dhe bashkësisë nga padrejtësitë.</p>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Në arkivin e familjes	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Grumbullon gjësende të veçanta familjare dhe të komunitetit, i klasifikon ato sipas llojit dhe bënë prezantimin e tyre (në klasë, grup, etj.). ▪ Mbledhë informacione për ngjarje të rëndësishme, nga familjarët dhe të tjerët, gjen të përbashkëtat dhe dallimet në mes tyre dhe i prezanton ato para të tjerëve. ▪ Krahason ngjarjet personale dhe familjare, dikur dhe sot dhe i identifikon ndryshimet në to kronologjikisht, përmes kujtimeve, fotove familjare dhe gjësendeve të tjera.
Unë, klasa dhe shkolla ime	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan grupet shoqërore ku bën pjesë (në familje, klasë, shkollë etj.) dhe dallon përbërjen e tyre. • Dallon llojllojshmërinë në klasë, shkollë dhe shoqëri dhe tregon mirëkuptim dhe respekt ndaj tjetrit (tjerëve) ndryshe. • Tregon shembuj konkretë të aktiviteteve shkollore (shënime të ditëve të veçanta, koncerte, shfaqje, gara, gjelbërimin e mjedisit etj.) dhe përshkruan mënyrën e planifikimit të tyre. • Merr pjesë aktive në organizimin e aktiviteteve në klasë dhe shkollë dhe kontribuon në mënyrë kreative në realizimin e tyre. 	

		<ul style="list-style-type: none"> Planifikon bashkërisht, me bashkëmoshatarët, aktivitete të ndryshme duke përcaktuar përbërjen dhe rolin e secilit anëtar pjesëmarrës.
	<p>Unë kam të drejta dhe përgjegjësi në shkollë dhe shoqëri</p>	<ul style="list-style-type: none"> Identifikon të drejtat themelore, në familje, në klasë, në shkollë dhe në shoqëri dhe i respekton ato. Evidencon raste të shkeljes së të drejtave të fëmijëve: në familje, në shkollë dhe në komunitet (shprehja e lirë, braktisja e shkollës, puna e detyruar, dhuna fizike e psikologjike etj.). Liston përgjegjësit e veta, të anëtarëve të familjes, të bashkësisë, shkollës dhe argumenton rëndësinë e zbatimit të tyre për të mirën e përgjithshme.
<p>Proceset shoqërore dhe natyrore</p>	<p>RNF:2. Njih rëndësinë e monumenteve, dukurive, proceseve historike, shoqërore, natyrore e mjedisore si dhe lidhjet dhe ndikimet ndërmjet tyre</p>	
	<p>2.1. Identifikon ngjarje shoqërore, kulturore e historike të nivelit lokal, vendor, kombëtar e më gjerë dhe shkaqet që sollën ato.</p>	
	<p>2.2. Kupton rëndësinë e objekteve, dukurive dhe proceseve shoqërore natyrore e mjedisore në nivel lokal, vendi, regjional dhe botëror.</p>	
	<p>2.3. Tregon respekt për trashëgiminë kulturore e natyrore si dhe shpreh solidaritet në proceset shoqërore ku ai është i përfshirë.</p>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	<p>Ngjarje dhe aktivitete në vendbani min tim</p>	<ul style="list-style-type: none"> Identifikon disa nga ngjarjet që organizohen në shkollë dhe rethin e tij dhe shpjegon arsyet e këtyre manifestimeve. Përshkruan ngjarje të ndryshme shoqërore e kulturore në vendbanimin e tij dhe ndërlidhë ato me objektet përkatëse. Liston monumentet e trashëgimisë kulturore në vendbanimin e tij, i veçon në bazë të dedikimit, funksionimit dhe shpreh kujdes për to.
	<p>Të afërmit e mi jetojnë në vende të</p>	<ul style="list-style-type: none"> Liston vendbanimet e të afërmëve të tij, brenda dhe jashtë vendit dhe tregon ku gjenden ato.

	ndryshme	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Identifikon dallimet dhe ngjashmëritë (në sjellje, në gjuhë, në veshje, në afinitete etj.) e të afërmeve të tij brenda dhe jashtë vendit.
	Raporti njëri natyrë	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Identifikon objekte dhe dukuri natyrore (lumi, liqeni, fusha, kodër/ mali, era, etj) të cilat kanë shërbyer dhe i shërbejnë njeriut për udhëtim, për ushqim, për energji etj. ▪ Tregon se njeriu në vazhdimësi e transformon natyrën për nevojat e veta (hap toka të reja, rrit plleshmërinë e saj, hap dhe ndërton rrugë, çelë kanale ujitjeje e lundrimi, akumulon ujin - liqet artificialë, ndërton ura etj.) dhe identifikon disa nga këto transformime në vendbanimin e tij. ▪ Dallon anët negative të ndërhyrjes së njeriut në natyrë (ndotja e mjedisit, shpyllëzimi, erozioni, dëmtimi i florës dhe faunës etj.) dhe përshkruan disa nga këto dukuri në vendbanimin e tij ▪ Tregon përgjegjësi për ruajtjen e natyrës (ndaj bimëve, kafshve, ujit etj.) dhe shpjegon ndërvarësinë njeri natyrë.
Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë	<p>RNF:3. Njeh dhe mëson të zbatojë normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet.</p> <p>3.1. Dallon llojllojshmërinë e etnive, kulturave, racave, besimeve, profesioneve në shoqëri dhe shpreh respekt për këtë diversitet.</p> <p>3.2. Tregon ndërgjegjshmëri për dallimet gjinore, liritë dhe të drejtat e njeriut dhe demonstroi tolerancë dhe solidaritet në komunikim dhe bashkëpunim me të tjerët.</p>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Llojllojsh mëri në shoqëri	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dallon diversitetin kulturor, etnik, fetar në mjedisin e tij shoqëror (familje, shkollë, komunitet) dhe shpjegon thjeshtë këto dallime. ▪ Identifikon profesione të ndryshme (mësues, mjek, artist, polic murator, bujk etj.) dhe arsyeton këtë llojllojshmëri veprimtarie.
	Vajza dhe djem - së bashku	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Tregon mirëkuptim, solidaritet midis të ndryshmeve (në aspektin gjinor) dhe angazhohet për trajtim të barabart mes tyre.

	dhe të barabartë	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Demonstron gatishmëri për bashkëpunimin gjinor (djalë, vajzë) në aktivitetet grupore (lojë, detyra, gara etj.) ▪ Identifikon të drejtat dhe përgjegjësitë individuale dhe grupore, dallon ndërlidhjen e tyre dhe jep shembuj konkretë nga jeta e përditëshme.
Vendimmarrja dhe institucionet	RNF: 4. Përfshihet në dhënien e ideve, propozimeve dhe merr vendime në mënyrë të përgjegjshme.	
	4.1. Identifikon dhe shpjegon faktorët që duhet të ketë parasysh me rastin e marrjes së vendimeve në situata të ndryshme nga jeta e përditëshme.	
	4.2. Kupton nivelet e ndryshme të vendimmarrjes në institucione dhe shoqëri, dikur dhe tani, dhe i respekton ato në veprimet e tij.	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Konsultohemi së bashku dhe vendosim	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vlerëson komunikimin (në grup, familje dhe shkollë) si element të përbashkët pozitiv për vendimmarrje të qëndrueshme. ▪ Diskuton me të tjerët përvoja të ndryshme para se të merr vendime për situata nga jeta e përditëshme. ▪ Gjykon se mendimet e ndryshme midis shokëve e shoqeve janë përparësi dhe jo pengesë për vendimmarrje të drejtë. ▪ Trajton vendimin e të tjerëve dhe vlerëson në mënyrë objektive (pa anime, tendenca) atë vendim.
Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm	RNF: 5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm	
	5.1. Shpjegon disa nga shkaqet dhe pasojat e rreziqeve natyrore e shoqërore si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe veprimeve të njeriut dhe merr pjesë në aktivitete për ruajtjen e mjedisit dhe përkujdesjen për trashëgiminë.	
	5.2. Bashkëpunon me të tjerët dhe ndërmer veprime të dobishme që promovojnë mjedisin e pastër, kujdeset për përdorim të drejtë të të mirave jetësore për higjienën e përgjithshme dhe për atë personale.	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Llojet e pasurive dhe ndarja	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dallon pasuritë natyrore (tokësore dhe nëntokësore, si p.sh.: xehet, ujërat, toka e punueshme etj.) dhe humane (trashëgimia kulturore, arsimimi profesionet etj.).

	e tyre	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ndërlidhë llojin e pasurive natyrore dhe humane me vendbaniminin (lokalitetin, rrethin) e tij/saj. ▪ Tregon se mbrojtja e pasurive nuk dmth mos-shfrytëzim, jep shembuj të shfrytëzimit racional të pasurive në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm (si pëdorimi racional i ujit, energjisë elektrike, druve, riciklimi i mbetjeve të ndryshme etj.)
	Gjendja e mjedisit në vendbani min tim	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përshkruan të veçantat e mjedisit natyror dhe kulturor (p.sh.bimë, kafshët , malet, fushat, vendbanimet, fabrikat, rrugët etj.), karakteristikë e vendit ku jeton, që tërheqin vëmendjen vizitorëve. ▪ Tregon e se njeriu është përgjegjës për përkujdesjen, mirëmbajtjen e mjedisit dhe shkaktari kryesor i ndotjes së tij. ▪ Demonstron veprime konkrete (në klasë, në shtëpi apo rrethinë) për një ambient dhe mjedis të qëndrueshëm.

Udhëzime metodologjike

Përcaktimi adekuat i njërive mësimore, të dala nga temat dhe rezultatet e të nxënit që janë të parapara me program, dhe përdorimi i metodologjisë adekuate të mësimdhënies sjellë suksese të dëshiruara te nxënësi.

Në funksion të realizimit të përmbajtjeve të lëndës Shoqëria dhe Mjedi dhe me qëllim të përmbushjes së kërkesave që ka ajo, mësimdhënësi zbaton metoda bashkëkohore të mësimdhënies që në qendër kanë nxënësin. Në bazë të kushteve dhe rrethanave zgjedh metodologjinë e punës, shfrytëzonë metodat mësimore, si procese të veprimeve të përbashkëta të mësimdhënies dhe nxënësit në mësim, që bazohen në lëndën mësimore, përmbajtjen mësimore, moshën, shkallën e zhvillimit psiko-fizik të nxënësve dhe kohës në dispozicion.

Nxënësi do të mësojë për vetveten, grupet shoqërore dhe mënyrat për përfshirje në to, duke mbledhur të dhëna dhe gjësende të veçanta, do të japë ide, propozime, do të bashkëveprojë e konsultohet me të tjerët për të marrë vendime të mira. Këto mundësohen përmes metodës verbale-tekstuale, bashkëbiseduese, përmes pyetjeve, diskutimit dhe të nxënit në bashkëpunim.

Në lidhje me rezultatet e parapara rreth objekteve kulturore e historike në nivel lokal, trashëgiminë kulturore e natyrore, planifikohet mësimi i cili realizohet gjatë vizitave në objektet shoqërore, kulturore e historike që i ka nxënësi në vendbanimin e vet.

Për shkak të moshës dhe shkallës së zhvillimit psiko-fizik të nxënësve, do të vazhdohet me metodën e lojës, e cila krijon shprehje të komunikimit efektiv, shkathtësi të të menduarit kreativ, aftësi bashkëpunuese dhe socializim në mes të nxënësve.

Mësimdhënësi duhet t'i kushtoj rëndësi edukimit mjedisor asisoj që te nxënësi të zhvillojë njohurit dhe shkathtësitë se si të mbrojnë e përmirësojnë atë përmes të nxënësve në veprim. Kjo metodologji nxënësin e mëson se si të ndërmer veprime që do të kujdeset dhe përmirësojë mjedisin. Gjithashtu është i rëndësishëm edhe aftësimi i nxënësve për të nxënë në mënyrë të pavarur, që të komunikoj, që të pranojnë mendimin e tjetrit, ndryshe. Sugjerohet që të përdoret mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në projekte, e cila zhvillon shkathtësitë praktike, hulumtuese, prezantuese të nxënësve.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema të rëndësishme me të cilat përballet shoqëria. Ato i shërbejnë zhvillimit të kompetencave dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin, të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme.

Nga mësimdhënësi kërkohet që në fazën e planifikimit të analizojë rezultatet e fushës, lëndës, temat dhe njësitet mësimore dhe të parashih se me cilat çështje ndërkurrikulare ndërlidhen ato. Në këtë mënyrë sigurohet trajtimi sa më i mirë i këtyre çështjeve duke marrë parasysh edhe mësimdhënien e integruar. Çështjet ndërkurrikulare që mund të përfshihen në lëndën/ fushën janë:

- Edukimi për qytetari demokratike
- Edukimi për paqe
- Globalizimi dhe ndërvarësia
- Edukimi për media
- Arsimi për zhvillimi të qëndrueshëm

Për shembull RNL-të, për temën Unë kam të drejta dhe përgjegjësi në shkollë dhe shoqëri, mund të ndërlidhet me çështjen ndërkurrikulare “Edukimi për qytetari demokratike”.

“Edukim për paqe”, si çështje ndërkurrikulare me përmbajtjet e saj si; toleranca mund të kontribuojë në arritje e RNL-ve për temën “Llojllojshmëri në shoqëri”. Ndërsa tema, “Globalizimi dhe ndërvarësia”, gjegjësisht përmbajtjet e saj lidhur me çështjet mjedisore, ndihmojnë në realizimin e temës së programit Gjendja e mjedisit në vendbanimin tim. “Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm” mund të ndërlidhet me temat me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në

ndërgjegjësimin e nxënësve për një qëndrim aktiv ndaj çështjeve dhe dukurive mjedisore, në nivel lokal dhe global. Këtu hyjnë çështjet si ndikimi i aktivitetit të njeriut në cilësinë e mjedisit, ngrohjen globale, biodiversitetin, energjia e ripërtëritshme etj.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi i nxënësve bazohet në rezultatet e të nxënësve të njohurive, shkathtësive, vlerave e qëndrimeve në funksion të kompetencave kryesore e rezultateve për fushë, lëndë dhe ato të orës mësimore dhe duhet të jetë i vazhdueshëm. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në planifikimin dhe përshtatjen e aktiviteteve mësimore që çojnë drejt realizimit të rezultateve të parapara. Janë me rëndësi informatat kthyes, të cilat vetdijësojnë nxënësit për të arriturat, anët e forta të tyre dhe drejtimit ku ata kanë nevojë për mbështetje e motivim.

Në këtë nivel synohet përforsimi dhe zhvillimi i njohurive, ndaj mësimdhënësi vlerëson jo vetëm nivelin e të kuptuarit, por edhe zbatimin në praktikë të njohurive të marra në mësim (ç'është në gjendje të bëjë nxënësi), që bëhet i dukshëm në rastet kur nxënësi merr pjesë në aktivitete, si: në përkujdesjen dhe ruajtjen e mjedisit dhe trashëgimisë, promovimin e mjedisit të pastër e të qëndrueshëm (aksione konkrete për pastrimin e ambientit), kur mirëkupton dhe respekton të gjithë rreth vetes (zbaton të drejtat e përgjegjësitë në klasë, shkollë, familje e rrethinë), jep ide për ndonjë projekt,etj.

Mësimdhënësi mban një regjistër personal ku evidencën arritjet e nxënësve. Ai përdorë instrumente të ndryshme për vlerësim, si: teste, ushtrime, dosje, lista kontrolli, detyra, por, gjithashtu, mbanë shënime rreth karakteristikave të nxënësit, aplikon vlerësimin përshkrues (si në shkallën e parë kurrikulare) në rastet kur aktivitetet e nxënësve nuk janë të matshme, si: aftësia e të shprehurit, kontributi në grup, aftësitë psiko-motorike, përdorë vëzhgimin e drejtpërdrejtë të vazhdueshëm, duke mbajtur shënime në situata të ndryshme mësimore si dhe rëndësi i kushton edhe vetvlerësimin.

Ashtu që nxënësit të pranojnë lehtësisht vlerësimin që u bëhet, mësimdhënësi duhet të ketë parasysh etikën gjatë procesit të vlerësimin. Pra, vlerësimi që bënë duhet të jetë përkrahës, motivues dhe shumë real.

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Për përvetësimin e shprehive dhe shkathtësive nga fusha e Shoqërisë dhe Mjedisit, mësimdhënësi duhet të shfrytëzojë burime të ndryshme mësimore, të cilat do të ndikojnë në motivimin e nxënësve për arritje sa më të larta. Ashtu që realizimi i orëve mësimore të jetë sa më efektiv dhe sipas kërkesave të përcaktuara me kurrikulën bërthamë, mësimdhënësi krijon një mjedis të përshtatshëm pune dhe siguron burime të ndryshme mësimore, të cilat, përveç teksteve mësimore

mund të jenë: librat e aktiviteteve dhe ushtrimeve, fletoret e punës, enciklopeditë, revistat, broshurat, burimet nga interneti (përdorimi i teknologjisë informative), materialet e krijuara nga vet mësimdhënësi, por edhe nga nxënësit, fotografitë, veshjet, mjetet të ndryshme.

Burimet mësimore duhet të organizohen mirë, të shfrytëzohen në mënyrë efektive edhe nga nxënësit, ashtu që të vie në shprehje të mësuarit përmes përvojës. Gjithashtu, nxënësve duhet t'u ofrohet qasje në objekte shoqërore (objekte të trashëgimisë kulturore) kulturore dhe natyrore dhe të planifikohen vizita të ndryshme njohëse në këto objekt.

FUSHA KURRIKULARE: EDUKATË FIZIKE, SPORTET DHE SHËNDETI

Kurrikula lëndore/programi mësimor
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Veprimtaria fizike-lëvizore dhe aktivitetet sportive janë pjesë domethënëse e procesit mësimor dhe zënë një hapësirë shumë të rëndësishme në rritje dhe zhvillimin psiko-fizik, social-emocional dhe shëndetësor të fëmijeve.

Edukata fizike, sportet dhe shëndeti synon të zhvillojë njohuritë dhe shkathtësitë e çdo fëmije bazuar në nevojat individuale të tij\ saj, të sigurojë përvoja, krijojë aftësi dhe shkathtësi të reja, të cilat do të zgjerojnë edhe më tej formimin kulturor, fizik e shëndetësor. Njohja dhe realizimi i veprimtarisë fiziko-lëvizore e sportive nga të gjithë fëmijët është formë e të vepruarit në grup dhe ndikon në përforcimin e marrëdhënieve emocionale, sociale dhe komunikuese.

Ky proces ka rëndësi të veçantë veçanërisht në realizimin e aktiviteteve dhe veprimtarive të tjera të kombinuara me ato artistike, shoqërore e shëndetësore.

Organizimi dhe realizimi i kësaj lënde do t'i ndihmojë fëmijët të vlerësojnë efektet pozitive të saj në shumë drejtime, jo vetëm në aspektin shëndetësor dhe fizik por edhe në krijimin e marrëdhënieve ndërnjerëzore, zgjerimin e njohurive për kulturat e rajoneve e të vendeve të ndryshme të cilat kontribuojnë në krijimin e mjedisit të shëndetshëm.

Qëllimi

Qëllimi i lëndës Edukatë Fizike Sportet dhe Shëndeti është të realizojë të gjitha rezultatet e fushës të përcaktuara në programin mësimor që duhet të zhvillohen në mënyrë të integruar nëpërmjet procesit mësimor teorik dhe praktik. Lënda Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti për klasën e tretë ofron mundësi të gjithë fëmijëve për të përfituar njohuri, shkathtësi, shprehje, qëndrime, vlera dhe sjellje, të cilat do t'i përgatisin për jetë të shëndetshme psikofizike. Po ashtu mundëson avansimin e aftësive, shkathtësive dhe shprehive fizike të vlefshme për stil të shëndetshëm të jetës, mbrojtjen e mjedisit si dhe përforcon konceptet si: përgjegjshmëria, individitë, grupi, shoqëria, rregulli, diversiteti, aktiviteti, kontributi shoqëror, etj.

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Nxënësit në klasën e tretë arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Edukatë fizike sporte dhe shëndeti, të shkallës së parë të kurrikulës (Shk1) në Kurrikulën bërthamë për arsimin e mesëm të ulët:

Njësitë tematike/mësimore përgjatë një klase/viti shkollor

1. Raportet ndërmjet individit dhe shoqërisë
2. Kujdesi në situatat urgjente
3. Elementet themelore të atletikës, gjimnastikës dhe sporteve tjera
4. Lëvizjet elementare motorike
5. Mënyra e jetesës, shprehitë dhe orari ditor
6. Shëndeti dhe kujdesi nga përdorimi i barnave
7. Mjedisi, loja dhe shëndeti

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL	
Mirëqenie plotë fizike, psikike, emocionale dhe sociale	<p>RNF: <i>1. Njohja dhe kuptimi i rëndësisë së mirëqenies fizike, psikike, emocionale dhe sociale</i></p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Menaxhon emocionet e tij/saj dhe i përshtat ato në situata të ndryshme dhe gjykon që çdo individ është unik, i ndryshëm, kontribuon që shkolla dhe mjedisi ku jeton të jetë i barrabartë dhe mikpritës për të gjithë.</i> 2. <i>Demonstron sjellje të përshtatshme në situata emergjente dhe zbaton parimet themelore të ndihmës së parë dhe ku mund të kërkojë ndihmë.</i> 	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Raportet ndërmjet individit dhe shoqërisë	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon rëndësinë e aplikimit të teknikave për lirim nga stresi në situata të caktuara • Vepron në situata të ndryshme që mund ta atakojnë në shkollë, familje e komunitet • Gjykon veprimet e veta dhe të tjerëve në situata të caktuara
	Kujdesi në situatat urgjente	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan situatat emergjente përmes shenjave të rrezikut • Shpjegon parimet kryesore të ndihmes së parë në raste të ndryshme të rrezikut • Demonstron shkathtësi për të kërkuar ndihmë në situata të caktuara nga individët dhe institucionet përkatëse
Zhvillimi i gjithanshëm dhe harmonik i	<p>RNF: <i>2. Përdorimi i aftësive dhe shkathtësive lëvizore në aktivitete fizike dhe sportive</i></p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Praktikon ushtrime themelore nga përmbajtja e atletikës, gjimnastikës</i> 	

trupit përmes aktiviteteve fizike dhe sportive	<i>dhe sportive tjera.</i> 2. Interpreton dhe zhvillon lëvizje të ndryshme në lojëra elementare, njeh dhe zbaton disa rregulla të cilat aplikohen në lojëra elementare.	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Elementet themelore të atletikës, gjimnastikës dhe sportive tjera	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • Vrapon në distanca të caktuara duke respektuar rregullat dhe krahasuar rezultatet e arritura • Hedh topthat në gjatësi të caktuar sipas udhëzimeve • Tregon pozitativitet dhe demonstroi shprehjet lëvizore që i kërkojnë veprimet gjatë të ushtruarit • Zhvillon shkathtësi lëvizore gjatë aktiviteteve sportive • Demonstroi shkathtësi dhe shprehjet të përshtatshme lëvizore bazuar në aftësi psikomotorike
	Lëvizjet elementare motorike	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • Demonstroi mënyrat e ngjitjes, bartjes së peshave në raport me mjetet në dispozicion • Demonstron në mënyrë të drejtë elementet e varjeve duke iu përshtatur veglave që shfrytëzohen • Demonstron shkathtësi dhe shprehjet lëvizore në mënyrë të përshtatshme në distanca të caktuar
Promovimi i stilit aktiv dhe të shëndetshëm të jetës	RNF: 3. Krijimi i shprehjeve për një stil jete aktive dhe të shëndetshme 1. Hulumton dhe zbulon si konsumues prejardhjen e ushqimit dhe harton plane të thjeshta individuale për ushqim të shëndetshëm sipas stileve, periudhave ditore, duke aplikuar rregullat elementare të ushqimit të shëndetshëm. 2. Demonstron shkathtësi për ruajtjen dhe kultivimin e higjienës personale dhe të mjedisit në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet.	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Mënyra e jetesës, shprehjet dhe orari ditor	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • Hulumton prejardhjen e ushqimit në piramidën ushqimore • Dallon prejardhjen e ushqimeve që konsumon në familje • Krijon një listë të ushqimit që do të konsumoj gjatë gjithë javës • Tregon rëndësinë e aplikimit të rregullave elementare të ushqimit të shëndetshëm për zhvillimin e trupit të tij/saj • Praktikoi shprehjet dhe shkathtësi për mbajtjen e higjienës personale dhe ruajtjen e mjedisit në shtëpi, shkollë e komunitet

Vetëdijësi për ndikimin e përdorimit të substancave që krijojnë varshmëri	<i>RNF: 4. Kuptimi i ndikimit të përdorimit të substancave që krijojnë varshmëri në jetën e individit dhe të shoqërisë</i>	
	<i>Nxënësi/ja:</i>	
	<i>1. Tregon dhe arargumenton mënyrën e sigurt të përdorimit të barnave dhe kupton se disa barna ndikojnë pozitivisht në shëndetin dhe mirëqenien e tij/saj.</i>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Shëndeti dhe kujdesi nga përdorimi i barnave	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • Tregon rreziqet e konsumimit të barnave pa prezencën e prindërve apo ndonjë të rrituri • Analizon situatat kur kemi nevojë dhe kur mundemi të përdorim barnat • Argumenton rëndësinë e vaksinimit për jetë të shëndetshme dhe të sigurtë nga epidemitë
Edukimi mbi mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm	<i>RNF: 5. Shfrytëzimi i mjedisit natyror për zhvillimin e aktiviteteve fizike dhe interesimi për t'u kujdesur dhe respektuar mjedisin</i>	
	<i>Nxënësi/ja:</i>	
	<i>1. Vlerëson rëndësinë e ndikimit mjedisor në të gjitha aktivitetet fizike dhe nëpërmjet veprimeve të veçanta tregon respekt dhe kujdes për mjedisin.</i>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Mjedisi, loja dhe shëndeti	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • Zgjedh mjedisin e përshtatshëm për aktivitet fizik duke u bazuar në kërkesat dhe rregullat e lojes • Kujdeset për mjedis të shëndoshë duke krijuar kushte të përshtatshme për mbarëvajtjen e aktiviteteve • Argumenton rëndësinë e ambientit të pastër për shëndetin dhe mbarëvajtjen e aktivitetit fizik

Udhëzime metodologjike

Realizimi i përmbajtjes në lëndën Edukatë Fizike Sportet dhe Shëndeti për klasën e tretë bëhet përmes përdorimit të metodave dhe teknikave të ndryshme të mësimdhënies të cilat duhet të jenë në përputhje me moshën e nxënësve por edhe t'i përshtaten përmbajtjes në mënyre që të arrihen rezultatet e përcaktuara me program.

Gjatë realizimit të aktiviteteve fizike dhe sportive theks të veçantë duhet t'i kushtohet mbajtjes së higjienës personale dhe të mjedisit ku zhvillohen. Gjithashtu duhet të kemi parasysh edhe

sigurinë e nxënësve në kuptimin e praktikave të sigurta të cilat duhet të behën shprehi tek nxënësit në mënyre ato të përvetësohen dhe ndiqen gjatë gjithë jetës së tyre.

Mësimdhënia është një proces ndërveprues i cili mbështetet në qasjen me nxënësin në qendër përmes përdorimit të metodave, teknikave të cilat sigurojnë mësimdhënie gjithëpërfshirëse për të gjithë nxënësit siç janë: metoda verbale, demonstrimit, asistimit, sintetike, analitike, konkretizimit, ilustrimit, imitimit, diskutimit, debatit, bashkëbisedimit, e të tjera të cilat mësimdhënësi i përzgjedh në varësi nga përmbajta e tematikave.

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave dhe teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike duke pasur gjithnjë parasysh moshën, potenciali, nevojat e veçanta dhe sigurinë e nxënësve.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Lënda Edukatë Fizike Sportet dhe Shëndeti ndërlidhet me fushat e tjera kurrikulare nëpërmjet të cilave nxënësit fitojnë njohuri dhe shkathtësi në lidhje me fenomene, dukuri, të cilat mundësojnë të nxënët gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm.

Realizimi i çështjeve ndërkurrikulare do të ndihmojë zhvillimin dhe plotësimin e përmbajtjes së fushës për arritjen e të gjitha kompetencave të përcaktuara me Kornizën e Kurrikulit të Kosovës. Disa nga çështjet ndërkurrikulare që i ndihmojnë nxënësit në këtë nivel janë:

- Globalizimi dhe ndërvarësia i referohet bashkëveprimit, kombinimit të aftësive dhe mundësive për të krijuar gjera të përbashkëta, kombinimit të përpjekjeve me të tjerët për të arritur suksese më të mëdha
- Shfrytëzimi medies i referohet përdorimit të medieve për sigurimin e informacioneve të reja dhe të drejta, krijimin dhe përdorimin e informatave, komunikimin përmes medieve tradicionale dhe digjitale, kritikën ndaj medieve, gjuhën e medieve dhe ndikimin e saj në shoqëri, pritjet e qytetarëve nga mediet dhe përdorimit të drejtë dhe të sigurtë
- Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, shërbimet për bashkësinë; siguria, mbrojtja e mjedisit natyror dhe human dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike;
- Gjuha dhe shkathtësitë e komunikimit në tërë Kurrikulën, cilësia e mirë e komunikimit në të gjitha lëndët;
- Zhvillimi personal dhe aftësitë për jetë, edukimi për konsumim dhe kursim; respekti për vete dhe për të tjerët, toleranca, vetëpërmbajtja, aftësia për marrëveshje; vetëiniciativa dhe përgatitjet për të ardhmen.
- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm i referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në ndërgjegjësimin e të rinjve/nxënësve për një qëndrim aktiv ndaj çështjeve dhe dukurive mjedisore, në nivel lokal dhe global

Në përgjithësi çështjet ndërkurrikulare pasurojnë dhe kontribuojnë në arritjen e rezultateve, andaj rëndësi duhet t'i kushtohet integritetit të tyre gjatë planifikimit dhe zbatimit. Megjithatë parësore

është puna e mësimit të cilin duhet t'u kushtoj kujdes çështjeve ndërkurrikulare që në fazën e planifikimit, të analizojë njësitë mësimore që ndërlidhen me çështjet ndërkurrikulare që të sigurohet të nxënës të integruar.

Integrimi i tyre mundëson përfshirjen e të gjitha aspekteve të rëndësishme shoqërore që trajtohen nga lëndë të ndryshme dhe me këndvështrime të ndryshme e cila mundëson arritjen e kompetencave të përcaktuara me KK.

Udhëzimet për vlerësim

Vlerësimi ka për qëllim mbledhjen sistematike të informatave të arritjeve të nxënës gjatë procesit të të nxënës, përkrahjen e nxënës në zotërimin e rezultateve të të nxënës, përcaktimin e nivelit të performancës për secilin nxënës. Vlerësimi i bazuar në kompetenca, në vete përmban informata të hollësishme kthyes të sakta dhe kritike përmbajtësore e konstruktive për të ndihmuar nxënës në arritjen e rezultateve të të nxënës në zotërimin e kompetencave.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në rezultatet e programit lëndor dhe mësimit të nxënës/ja nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënës për ato rezultate që nuk përshkruhen në program mësimor. Objektivi i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat.

Mësimit të nxënës/ja zhvillon një larmi mënyrash vlerësimi për shembull:

- Përshkrim gojor të lëvizjeve që duhet përmirësuar.
- Testi me shkrim i standardizuar
- Pjesëmarrja aktive gjatë orës mësimore (listë kontrolli)
- Ese (hulumtim individual apo grupor për temat e edukimit shëndetësor)
- Ilustrimet apo shprehje tjera krijuese
- Video incizimet

Ndërkaq tek Edukata fizike dhe sportet fokusi i mësimit të nxënës duhet të jete në vlerësimin e këtyre elementeve:

- Korrigjim me takt i lëvizjeve jo të drejta
- Lista e kontrollit
- Pjesëmarrja aktive në lojërat elementare gjatë orës mësimore
- Me zgjedhjen e nxënësve më të shpejt në vrapim
- Me kompozim ushtrimesh fizike dhe me pikë.
- Me sistem pikësh për ushtrimet e veçanta.
- Me sistem pikësh për vallëzimin e kompozuar.
- Me pikë për veprime individuale.
- Me pikë për grupin me të mirë gjate lojës apo garës
- Me pikë për skemat lëvizore të vrapimeve të ndryshme.

Këtyre vlerësimeve mund t'u shtohen edhe vlerësimet mbi aktivizimin në veprimtaritë e ndryshme sportive.

Portfolio e nxënësve është mundësi vlerësimi dhe vetëvlerësimi e cila përmbledh performancën e nxënësit gjatë vitit shkollor për një fushe të caktuar. Gjithashtu portfolio mund të përmbajë detyra tematike praktike, foto dhe CD të demonstrimit të aftësive lëvizore për linja të ndryshme të programit, angazhime në veprimtari të ndryshme shkollore etj.

Udhëzime për materialet didaktike dhe burimet e mjetet mësimore

Për realizimin me sukses të kompetencave në fushën mësimore Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti është e rëndësishme të përdoren burime të ndryshme mësimore që i motivojnë fëmijët dhe stimulojnë progresin e tyre në mënyre që të krijojnë shprehi dhe shkathhtësi të nevojshme për jetë.

Për realizimin më të suksesshëm të fushës mësimore Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti duhet të përdoren një spektër i gjerë i burimeve mësimore, përfshirë tekstet, librat e aktiviteteve dhe të ushtrimeve, librat e punës, broshura, atlase, enciklopedi, softuerë arsimorë, projekte, studime të ndryshme, analiza dhe raporte të ndryshme të lëmit përkatës dhe libra të tjerë.

Edukatoret dhe fëmijët mund të angazhohen në hartimin dhe shfrytëzimin e materialeve mësimore, p.sh.: rezultatet e projekteve të realizuara nga fëmijët mund të bëhen burime të vlefshme mësimore për klasa të ndryshme.

FUSHA KURRIKULARE: JETA DHE PUNA

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Shkathtësi për jetë

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Shkathtësi për jetë

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Lënda Shkathtësi për jetë në klasën e tretë është vazhdimësi dhe zgjerim i njohurive drejt përvetësimit të njohurive të reja, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave për të ngritur vetëdijesim dhe vetëbesim për ushtrimin e punës praktike, përdorimin e TIK-ut, bashkëpunimin lidhur me ekonominë familjare, me mjedisin jetësor dhe orientim për jetë dhe punë.

Lënda Shkathtësi për jetë ndihmon që nxënësit të përgatiten për punë dhe jetë në shekullin 21, duke e kaluar theksin nga mësimdhënia e njohurive të nxënësve pasiv në atë të zhvillimit të kompetencave, shkathtësive dhe qëndrimeve përmes mësimnxënies aktive.

Në kuadër të lëndës Shkathtësi për jetë do të zhvillohen module të cilat synojnë të përmbushin konceptet kryesore të fushës Jeta dhe Puna për shkallën 2 si: Punëdore, Zhvillimi personal, shkathtësi për jetë, Këshillimi dhe Orientimi në Karrierë, Ekonomia familjare, Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm dhe Puna dhe edukimi për ndërmarrësi. Të gjitha këto koncepte zhvillohen në ndërlidhje të rezultateve të fushës dhe të lëndës për të arritur qëllimin kryesor të fushës Jeta dhe Puna.

Kjo lëndë përfshin përpjekjet sistematike për të ndikuar në procesin e zhvillimit të nxënësve të cilët përmes procesit të të mësuarit përdorin materiale të ndryshme, mjetet e punës të cilat kontribuojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e shkathtësive dhe aftësive për jetë dhe punë.

Lënda ndikon tek fëmijët në zhvillimin e mendimit kritik, zhvillimin e aftësive për të zgjidhur probleme, nxitjen e kreativitetit, aftësinë prezantuese, rritjen e vetëbesimit dhe punën ekipore.

Qëllimi

Qëllimi i lëndës Shkathtësi për jetë për klasën e tretë është që nxënësi të njihet me rolet e ndryshme të individëve në jetë dhe punë, të njihet me materialet e ndryshme dhe përdorimin e tyre, njohjen nga rreziqet, zhvillimin e karrierës, planifikimin e ekonomisë familjare, mjedisin dhe shëndetin, si dhe mediat.

Nëpërmjet lëndës Shkathtësi për jetë rritet niveli i njohurive dhe shkathtësive për jetën e përditshme duke përfshirë konceptet bazë të fushës Jeta dhe puna.

Përmes lëndës Shkathtësi për jetë për klasën e tretë mësimi në shkollë bëhet më atraktiv dhe më i kënaqshëm përmes aktiviteteve të ndryshme praktike në të cilat nxënësit nxiten që të marrin pjesë. Synimi kryesor në klasën e tretë është që nxënësit të identifikojnë interesimet e tyre për ndonjë veprimtari apo shkathtësi, siç janë: përpunimi i materialeve ricikluese, moderimi, krijimi i gazetës shkollore apo asaj në klasë, qepja, prerja, matja, organizime të ndryshme (humanitare, argëtuese) etj.

Shkathtësitë më të rëndësishme jetësore që nxënësi duhet t'i arrijë nëpërmjet lëndës Shkathtësi për jetë janë:

- Të menduarit kreativ dhe kritik
- Shkathhtësitë për zgjidhjen e problemeve
- Shkathhtësitë e marrjes së vendimeve
- Shkathhtësitë e komunikimit
- Ballafaqimi me emocionet dhe stresin
- Aftësitë për të prezantuar
- Puna në grup
- Shkathhtësitë sipërmarrëse.

Temat dhe rezultatet dhe të nxënimit

Nxënësit në klasën e tretë arrijnë rezultatet e të nxënimit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënimit të fushës (RNF) Jeta dhe puna, të shkallës së parë të kurrikulës (SHk 1) në Kurrikulën bërthamë për arsimin fillor:

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL	
Zhvillimi i bazuar në aktivitete praktike manuale (Punëdore)	RNF 1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet. 1.1. Përshkruan ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bëhen individualisht dhe në grup. 1.2. Ndërmerr aktivitete praktike bazuar në vetiniciativë dhe në qasje të pavarura për të finalizuar produkte të ndryshme punëdore, duke u nisur nga një model i dhënë, fotografi a vizatim. 2. Ngritja e cilësive personale për jetë dhe punë Demonstron gadishmëri dhe vetiniciativë për pjesëmarrje dhe organizime të aktiviteteve të ndryshme grupore në shkollë dhe në komunitet duke respektuar rregullat e ndërveprimit dhe të punës në grup.	
	Tema	Rezultatet e të nxënimit të lëndës (RNL)
	1. Materialet dhe përpunimi i tyre	Nxënësi: -Përshkruan procesin e prodhimit të letrës dhe të kartonit. -Klasifikon llojet e letrës dhe të kartonit. -Identifikon vetitë e ndryshme të letrës dhe të kartonit. -Modelon objekte nga letra dhe kartoni. -Dallon materialet si: leshi, pambuku dhe materialet sintetike si zëvendësim i materialeve natyrore. -Përshkruan procesin e qethjes, larjes, pastrimit dhe krehjes së leshit.

		-Përshkruan procesin e kultivimit, tjerres, ngjyrosjes dhe endjes së pambukut.
Zhvillimi personal, shkathtësi për jetë	RNF 3. Përdorimi i teknologjisë për jetë dhe për punën e përditshme 3.1. Përdorë vegla dhe pajisje shtëpiake në situata të përditshmërisë 6. Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe për punë 6.1. Përshkruan rregullat për mbrojtje dhe siguri, nga rreziqet në jetën e përditshme: në shtëpi, në shkollë dhe në mjedis.	
	2. Njohja nga rreziqet	Nxënësi: -Përshkruan burimet kryesore të rreziqeve nga pajisjet dhe instalimet e ndryshme elektrike. -Zbaton rregullat e përdorimit të drejtë të pajisjeve elektrike: prizat, çelësat, poçat, përcuesit etj. -Identifikon shkaqet potenciale për shpërthimin e zjarrit dhe merr masa preventive për parandalimin e tij. -Identifikon rrezikun nga lëvizjet e pakujdesshme në pjesët e larta të objekteve të banimit, ballkone, kulme, ashensorë, pastaj puse, puseta etj., si dhe masat preventive për menjanimin e këtyre rreziqeve. -Njihet me rreziqet që shkaktojnë valët e internetit, telefonit etj., dhe vetëdijesohet për përdorimin e drejtë të pajisjeve elektronike. -Identifikon disa nga substancat kryesore kimike dhe mjetet shpërthyesë që mund t'i hasë nxënësi në shtëpi, shkollë, terren të hapur etj.
Këshillimi dhe orientimi në karrierë	RNF 4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme 4.1. Përdorë kompjuterin personal për të reflektuar ide dhe krijimtari fillestare. 4.2. Përdorë sigurt TIK-un për të krijuar projekte të ndryshme, planifikim të aktiviteteve, krijim të detyrave, hulumtim dhe zhvillim të shkathtësive praktike. 7. Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme 7.1. Demonstron përmes veprimeve të veta nevojën për marrjen e përgjegjësive, ndarjen e aktiviteteve që zhvillohen në shtëpi, shkollë dhe komunitet.	
	3. Karriera ime	Nxënësi: -Prezenton para klasës përmes TIK-ut imazhe që

		<p>ndërlidhen me punën dhe profesionet.</p> <p>-Identifikon përmes objekteve/institucioneve llojet e vendeve të punës.</p> <p>-Paraqet shkathtësi dhe dëshirën për profesionin e tij të ardhshëm.</p> <p>-Krijon një projekt të vogël me materiale të ndryshme që lidhen me profesione të caktuara.</p>
Ekonomia familjare	<p>RNF</p> <p>1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet</p> <p>1.2. Ndërmerr aktivitete praktike bazuar në vetiniciativë dhe në qasje të pavaruara për të finalizuar produkte të ndryshme punëdore duke u nisur nga një model i dhënë, fotografi a vizatim.</p> <p>5. Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë dhe planit të biznesit</p> <p>5.1. Drejtpërdrejt hulumton dhe përfshihet në aktivitete të ekonomisë familjare dhe ushtron përgjegjësi elementare organizative–buxhetore, duke zhvilluar shpirtin e ndërmarrësit.</p>	
	4. Planifikimi	<p>Nxënësi:</p> <p>-Kontribuon në ekonominë familjare.</p> <p>-Organizon aktivitete argëtuese, humanitare, ruajtjen e mjedisit etj.</p> <p>-Planifikon dhe punon një produkt prej materialeve recikluese.</p>
Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm	<p>RNF</p> <p>6. Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe për punë</p> <p>6.1. Përshkruan rregullat për mbrojtje dhe siguri, nga rreziqet në jetën e përditshme: në shtëpi, në shkollë dhe në mjedis.</p> <p>9. Mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe e mjedisit</p> <p>9.1. Përpunon materiale recikluese bazike nga ekonomia familjare dhe merr masa mbrojtëse për ruajtjen e mjedisit.</p> <p>9.2. Zhvillon njohuri dhe shkathtësi për shoqërinë, mbrojtjen e mjedisit, ekonominë familjare dhe përdorimin e TIK-ut.</p>	
	5. Mjedi dhe shëndeti	<p>Nxënësi:</p> <p>-Identifikon repartet, punishtet dhe pajisjet që prodhojnë zhurmë të lartë: si ato për përpunimin e drurit, të materialeve plastike etj., që gjenden pranë mjedisit jetësor.</p>

		<p>-Përpilon orarin e lojës apo të argëtimit në kohën kur nuk pengon në mjedisin jetësor.</p> <p>-Përshkruan dëmet që shkaktohen në mjedis nga djegia e mbeturinave, tymtarët e fabrikave, liri i gazrave nga makinat etj.</p> <p>-Prezanton situatat e ndryshme se si bëhet mbrojtja e mjedisit.</p> <p>-Përshkruan prezencën e deponive, grumbullimin e mbeturinave dhe reciklimin e tyre.</p>
Puna dhe edukimi për ndërmarrësi	<p>RNF</p> <p>2. Ngritja e cilësive personale për jetë dhe punë</p> <p>2.1. Demonstron gadishmëri dhe vetinativë për pjesëmarrje dhe organizime të aktiviteteve të ndryshme grupore në shkollë dhe në komunitet duke respektuar rregullat e ndërveprimit dhe të punës në grup.</p> <p>4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme</p> <p>4.1. Përdor kompjuterin personal për të reflektuar ide dhe krijimtari fillestare.</p> <p>4.2. Përdorë sigurtë TIK-un për të krijuar projekte të ndryshme, planifikim të aktiviteteve, krijim të detyrave, hulumtim dhe zhvillim të shkathtësive praktike.</p>	
	Mediat	<p>Nxënësi:</p> <p>-Prezanton para klasës disa lloje mediash që shikon në shtëpi për moshën e tij.</p> <p>-Moderon aktivitete brenda klasës para prindërve për festa të ndryshme.</p> <p>-Organizon aktivitete të lira në kuadër të grupeve kulturore brenda klasës.</p> <p>-Prezanton përmes TIK-ut aktivitetet e grupit të tij për një periudhë të caktuar kohore.</p> <p>-Krijon fletushkën e klasës me punime të shkruara me dorë dhe me imazhe interesante.</p>

Udhëzime metodologjike

Për realizimin e përmbajtjeve që përcaktohen në lëndën Shkathtësi për jetë për klasën e tretë mund të përdoren metodat e ndryshme të punës me qëllim të përmbushjes së kërkesave që ka kjo lëndë, por edhe për shkak të specifikave që mbart në vete. Disa prej metodave që e lehtësojnë zhvillimin e suksesshëm janë metodat e mësimdhënies që në qendër kanë nxënësin.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:

- Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
- Të mësuarit dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;
- Ushtrimet me luajtje rolesh;
- Inkurajimi i punës individuale dhe shkëmbimi i njohurive dhe shkathtësive, puna interaktive;
- Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.

Në të gjitha rastet, zbatimi i metodave apo teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialit dhe të mjeteve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritura.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Në kuadër të lëndës Shkathtësi për jetë një ndër qëllimet e rëndësishme të saj duhet të jetë edhe realizimi i çështjeve ndërkurrikulare, që do të ndihmojnë në arritjen e kompetencave kryesore të parapara me KK. Çështjet ndërkurrikulare që duhet të merren në konsideratë në këtë nivel, dhe që mund të trajtohen në vazhdimësi edhe në nivelet e tjera, janë:

- Edukimi për qytetari demokratike
- Edukimi për paqe
- Globalizimi dhe ndërvarësia
- Edukimi për media
- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Lënda Shkathtësi për jetë duhet realizuar në atë mënyrë që t'u mundësojmë nxënësve përmirësimin dhe zbatimin gradual të kompetencave kryesore të parapara në KK. Organizimi i mësimit duhet të përqendrohet në atë se çka duhet të dinë dhe çka duhet të jenë në gjendje të bëjnë nxënësit. Ajo pasqyrohet përmes njohurive, shkathtësive, shprehive, por edhe përmes qëndrimeve dhe sjelljeve që ata duhet t'i reflektojnë.

Në kuadër të lëndës Shkathtësi për Jetë një ndër qëllimet e rëndësishme të saj duhet të jetë edhe realizimi i çështjeve ndërkurrikulare, që do të ndihmojnë në arritjen e kompetencave kryesore të parapara me KK.

Disa nga çështjet ndërkurrikulare që duhet të merren në konsideratë në këtë nivel, por që mund të trajtohen në vazhdimësi edhe në nivelet e tjera, janë:

- Njohja e medias (përdorimi i medias për ta kuptuar botën përreth);
- Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm (shërbimet për bashkësinë);
- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike;
- Gjuha dhe shkathtësitë e komunikimit;
- Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë;
- Puna vullnetare.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është një element i pranishëm në çdo veprimtari mësimore. Matja dhe vlerësimi janë pjesë përbërëse dhe mjaft të rëndësishme të mësimdhënies në shkollën bashkëkohore.

Nxënësit nxënë mjaft gjatë viteve të shkollimit. Sidoqoftë, jo gjithçka që ata nxënë mund të matet me anë të testeve, edhe për faktin se, për nxënësit e nivelit fillor, përdorimi i teknikave të ndryshme mundëson vlerësim sa më realist bazuar në karakteristikat e ndryshme të nxënësve.

Lënda Shkathtësi për jetë, për shkak të natyrës dhe specifikave që ka, kërkon shumëllojshmëri të mënyrave të vlerësimit në baza të rregullta, ku fokusi është mbi të kuptuarit e jetës dhe të punës; konceptet dhe praktikimi i sjelljeve dhe i qëndrimeve pozitive. Me fjalë të tjera, nxënësit duhet të jenë në gjendje në vazhdimësi dhe në mënyrë aktive të zbatojnë në praktikë njohuritë e mësuara në jetën e tyre të përditshme.

Për shkak të specifikave që ka kjo lëndë do të ishte e vlefshme që, përveç vlerësimit numerik, në masë të madhe të aplikohet vlerësimi përshkruar pasi puna në grup, projektet, aftësitë psikomotore, aftësia e të folurit etj., nuk mund të maten me anë të testeve. Për t'i matur dhe për t'i vlerësuar ato, përdoren instrumente të tjera. Vëzhgimi i drejtpërdrejtë është një procedurë e përshtatshme për lëndën Shkathtësi për jetë dhe punë, e cila mund të përdoret në situata të ndryshme mësimore dhe në të gjitha nivelet e shkollimit.

Ekzistojnë disa teknika dhe instrumente që ndihmojnë në vrojtimin e drejtpërdrejtë të veprimtarisë së nxënësit, të cilat përdoren për vlerësim. Ja disa prej tyre:

Buletini i pjesëmarrjes, përshkruhet si një teknikë vrojtimi që mund të përdoret për të vrojtuar, në grupe të vogla ose gjatë diskutimit. Buletini tregon se cili jep ndihmesë, sa shpesh bashkëpunon, sa të vlefshme janë ndihmesat etj.

Lista e kontrollit, është një instrument që përmban një listë me tema, objektiva, njohuri, për të cilat nxënësi do të vëzhgohet. Qëllimi kryesor i listës së kontrollit është të regjistrojë një

vlerësim të vazhdueshëm për përparimin e nxënësit, duke dëshmuar se si i përmbush ai detyrat ose objektivat e llojeve të ndryshme. Krahas listës me elementet që do të vrojtohen, jepet edhe një shkallë vlerësuese.

Dosja e nxënësit, është një mjet që mund të përdoret për të treguar modele të punëve të nxënësve, të cilat dëshmojnë përparimin e nxënësit, aftësitë e tij dhe nivelin e punimeve. Dosja mund të përmbajë, për shembull, vizatime, një projekt, një krijim, plane etj.

Dosja ka vlera për këto arsye:

- Është një mjet që u jep informacion mësuesit, prindërve dhe nxënësve.
- Nxënësit i jep një pasqyrë tërësore të punës së tij.
- Duke e përgatitur vetë dosjen, nxënësi luan rol aktiv në procesin e mësimit dhe të vlerësimit.

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Për realizimin me sukses të kompetencave në lëndën Shkathësi për jetë është e rëndësishme që të përdoren burime të ndryshme mësimore për t'i motivuar nxënësit dhe për të stimuluar progresin e tyre në mënyrë që të përvetësojnë shprehje dhe shkathësi të nevojshme për jetë dhe për punë në jetën e përditshme. Meqenëse tekstet shkollore janë burime të vlefshme dhe të rëndësishme të nxënies, qasja e nxënësve në informacion nuk duhet kufizuar vetëm në tekstet shkollore, por edhe në burime të tjera të cilat i shërbejnë për të planifikuar dhe për të realizuar procesin mësimor në klasë.

Për realizim më të suksesshëm të lëndës Shkathësi për jetë duhet të përdoret një spektër i gjerë i burimeve mësimore, përfshirë tekstet shkollore, librat e aktiviteteve dhe të ushtrimeve, librat e punës, broshura, atlase, enciklopedi, softuerë arsimorë, projekte, studime të ndryshme, analiza dhe raporte të ndryshme të lëmit përkatës dhe materiale përkatëse pune. Mësimdhënësit, nxënësit dhe bartësit e tjerë të arsimit, po ashtu mund të angazhohen në hartimin e burimeve të përshtatura mësimore, p.sh., rezultatet e projekteve të realizuara nga nxënësit mund të bëhen burime të vlefshme mësimore për klasa të ndryshme.

Mësimdhënësit mund të përgatisin dosje, gazeta, revista, literaturë të specializuar apo doracakë të ndryshëm për aktivitete me nxënës. Gjithashtu, është shumë me rëndësi që nxënësit dhe mësimdhënësit të bashkëpunojnë edhe për prodhimin e materialeve të ndryshme përmes shfrytëzimit të burimeve të teknologjisë informative.